



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në
Edukim me profil
“Mësimdhënia dhe të Nxënit”
Universiteti “Barleti”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Erleta Çelmeta (Mato) 

Prof. Asoc. Dr. Dilina Beshiri 

Qershor /2022

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Master Profesional në Edukim me profil “Mësimdhënia dhe të Nxënit”

1	IAL aplikues:	Universiteti “Barleti”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional
3	Emërtimi i programit të studimit:	Mp në Edukim me profil “Mësimdhënia dhe të Nxënit”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS Nr. 549, datë 11.11.2011, sipas këtij urdhëri është hapur me emërtimin: MP në Edukim me dy profile: Mësimdhënia e të nxënit; Administrim i arsimit;
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Shkresë MASR me Nr. 2404/1 prot, datë 08.05.2018, është bërë riorganizimi duke ndryshuar emërtimin në : Mp në Edukim me profil “Mësimdhënia dhe të Nxënit”
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 54, datë 29.06.2015
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	7 PAE / 2 PAK
18	Numri i studentëve:	2019-2020 13 studentë; 2020-2021 10 studentë;



Guato

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në kuadrin e akreditimit të programit të studimit ciklit të dytë Master Profesional në Edukim me profil “Mësimdhënia dhe Të nxënit” kërkuar nga Institucioni i Arsimit të Lartë, Universiteti “Barleti” (UniBa)Tiranë, është realizuar procesi respektiv i vlerësimit, duke u bazuar fillimisht në aktivitetet e realizuara, sipas agjendës së miratuar nga dy institucionet. Në këtë raport janë pasqyruar gjetjet që kanë dalë si rezultat i analizës për procesin e vlerësimit të jashtëm.

Objekti i këtij vlerësimi të jashtëm është programi i studimit me kohë të plotë ciklit të dytë Master Profesional në Edukim me profil “Mësimdhënia dhe të Nxënit” i ofruar nga Departamenti Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional (DSHETP) si njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit në Universitetin “Barleti”.

Programi i ciklit të dytë Master Profesional në Edukim me profil “Mësimdhënia dhe të Nxënit”, është rrjedhojë e riorganizimit të programit Master Profesional në “Edukim” me dy profile,

i. Mësimdhënia e të Nxënit; ii. Administrim i Arsimit; licensuar sipas Urdhërit Nr. 549, datë 11.11.2011, të MASH, që realizohej me 60 kredite me kohëzgjatje normale 1.5 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë. Ky program u akreditua me Vendim të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë Nr.54 , datë 29.06.2015 me vlefshmëri akreditimi maksimale (me 6 vite) deri në 29.06.2021.

Programi u riorganizua në zbatim të ligjit Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 83, pika 2, që përcakton se studimet në ciklin master në fushën e mësuesisë duhet të jenë me 120 kredite. Programi i riorganizuar me 120 kredite, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike(4 semestra) u miratua nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me shkresë Nr. 2404/1, datë 8.05.2018.

Programi i studimit, bazuar në VKM Nr.41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar me VKM nr 879, datë 18.12.2019 dhe shtojcat e tij, respekton kriterin që 30%-40% e programit të jenë lëndë karakterizuese të disiplinës shkencore ose ndryshe 36-48 kredite të ofrojnë formim në profilin përkatës të mësuesisë të kryer në studimet paraardhëse (diplomë e integruar në mësuesi apo studime bachelor që mundësojnë studime të mëtejshme në mësuesi/edukim), sepse krahas formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik të domosdoshëm në një program masteri në mësuesi, mundëson që nëpërmjet lëndëve, si më poshtë:

1. “Hartimi dhe zbatimi i kurrikulës (kurrikula e arsimit parashkollor, arsim fillor, gjuhët, shkencat sociale, matematikë, shkencat e natyrës, TIK, artet, arsim profesional)” 8 kredite
2. “Kompetencat kyçe në arsimin parauniversitar” 7 kredite
4. “Praktikë profesionale” sipas profileve 12 kredite
5. “Provë finale /Tezë përfundimtare” sipas profilin 24 kredite,

3
Guato

të realizojë formimin e duhur në profilin përkatës të mësuesisë për studentin. Kjo është shprehur dhe në propozimin me të cilin UniBa ka riorganizuar programin nga 60 kredite me 120 kredite dhe që është miratuar nga MASR me shkresën e saj, zyrtare nr. 2404/1 prot, datë 08.05.2018.

Numri i studentëve sipas viteve është:

- Për vitin akademik 2018-2019 12 studentë;
- Për vitin akademik 2019-2020 13 studentë;
- Për vitin akademik 2020-2021 10 studentë;
- Për vitin akademik 2021-2022 7 studentë;



Gueto

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Metodologjia e përdorur për realizimin e vlerësimit të jashtëm

Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë nga ana e programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Edukim me profil “Mësimdhënia dhe të Nxënit”.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof. Dr. Erleta Mato dhe Prof.Asoc.Dr. Dilina Beshiri dhe gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Majlinda Demirneli.

Baza ligjore mbi të cilin është mbështetur procesi i vlerësimit të jashtëm është:

- Ligji nr.80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”
- MAS, shkresa e saj, zyrtare nr. 2404/1 prot, datë prot, datë 08.05.2018.
- VKM nr. 531, datë 11.09.2018 “Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë”
- Manuali për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, ASCAL 2017.

Aktivitet kryesore të realizuara

Në kuadër të këtij vlerësimi janë realizuar disa aktivitete. Kështu, është realizuar analiza e të dhënave parësore dhe dytësore.

Analiza e të dhënave parësore. Të dhënat parësore janë marrë nga Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Edukim me profil “Mësimdhënia dhe të Nxënit” (nëntor 2021), i realizuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm, Statuti i UniBa, Rregullore e UniBa, Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit (FSHST), paketa e plotë e dokumentacionit të programit, programet lëndore, si dhe dokumentacione të tjera administrative dhe profesionale, siç janë: Rregullorja e programit, plani mësimor, programet lëndore, paketa e praktikës, dokumentacioni i personelit, etj.

Analiza e të dhënave dytësore. Analiza e të dhënave dytësore u mbështet në të dhënat e marra nga takimet e realizuara në institucion, përkatësisht:

- Takim me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjësën e Departamentit që mbulon programin e studimit
- Takim me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm
- Takim me stafin akademik që angazhohet në këtë program
- Takim me studentë të këtij programi
- Takim me përfaqësues të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë dhe Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave
- Takim me përfaqësues të Zyrës së Njësisë së Sigurimit të Standardeve të Cilësisë, dhe Zyrës së Sigurimit të Cilësisë së Studimeve Maste
- Takim me përfaqësues të Zyrës së Alumni dhe Karrierës dhe Zyrës së Shërbimeve Studentore
- Takim me Përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore

-Takim në Sekretarinë mësimore -Takim përfundimtar me Përgjegjësën e Departamentit

Gjatë këtyre takimeve u zhvilluan biseda të qëllimta që synonin mbledhjen e informacioneve të domosdoshme lidhur me zbatimin e këtij programi, ballafaqimin e tyre me gjetjet dhe konkluzionet e raportit të vlerësimit të brendshëm.

Nga ana tjetër, si pjesë e metodologjisë së ekipit të vlerësimit të jashtëm, u realizua:

Vëzhgimi i mjediseve

Ekipi i vlerësuesve të jashtëm vëzhgoi mjediset mësimore që ishin në dispozicion të programit të studimit, si: auditorë, laboratorë të informatikës, të sekretarisë, si edhe të mjediseve dhe literaturës së bibliotekës. Duke u mbështetur mbi analizën e të dhënave të marra nga këto burime, si dhe nga puna në ekip e vlerësuesve të jashtëm është hartuar dhe raporti i vlerësimit të jashtëm.

Universiteti “Barleti” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 27.05.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 20/40 Prot, datë 27.05.2022. Universiteti “Barleti” përcjell në ASCAL më datë 01.06.2022, me anë të shkresës me Nr. 697 Prot, datë 30.05.2022, “Komentet lidhur me Draft Raportet e Vlerësimit të Jashtëm”, ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional“ Mësimdhënia dhe të Nxënit”


I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi I.1				
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit Master në “Mësimdhënie dhe të nxënit” është një program që stimulon përgatitjen e specialistëve të edukimit në funksion të interesave kombëtare për një cilësi më të mirë të arsimit në të gjitha nivelet e shkollimit			
Kriteri 2 Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Duke nxitur zhvillimin e kompetencave profesionale, ky program studimi bën të mundur konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore në sistemin arsimor shqiptar përmes pasurimit të traditës me koncepte dhe aftësi bashkëkohore			
Kriteri 3 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Bazuar në qëllimet dhe misionin e institucionit “Barleti”, si dhe fushën e veprimtarisë mësimore, ky program studimi është ofruar në përputhje me to dhe prezantohet si në strategjinë e zhvillimit, ashtu edhe në rregulloren e institucionit dhe Departamentit të Edukimit dhe trajnimit Profesional. <i>(Evidenca 3 Strategjia e Zhvillimi Institucional); (Evidenca 5 Rregullore UniBA.)</i>			
Kriteri 4 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Ky program i nivelit të dytë Master profesional në “Mësimdhënie dhe të Nxënit” i është nënshtruar sfondit të zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar, duke tentuar të përmirësojë cilësinë e arsimit në funksion të tregut të punës dhe kërkesave gjithnjë në rritje të formimit të specialistëve me kompetencat e nevojshme për punë dhe jetë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatorë të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Guato


<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Neni 4 i Statutit, përcakton se “Misioni i UniBa është të përgatisë studentët si profesionistë novatorë, krijues e sipërmarrës , të aftë për sfidat e të tashmes dhe të ardhmes, si dhe qytetarë të angazhuar të një bote në ndryshim dhe në zhvillim të vazhdueshëm”. (<i>Statuti i Universitetit “Barleti”, faqe 1</i>), karakteristikë kjo e zhvilluar gjerësisht në strategjinë e institucionit.</p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Statuti përcakton qartë se “Vizioni i UniBa është krijimi i një institucioni të arsimit të lartë cilësor, si një aktor i zhvillimit, i cili ofron vlera të vërteta profesionalizmi dhe qytetarie, nëpërmjet një edukimi ndërdisiplinor të përgatisë individë të angazhuar dhe me integritet në një mjedis social aktiv”. (<i>Statuti i Universitetit Barleti, faqe 2</i>)</p> <p>Po ashtu, në rregulloren e programit të studimit nënvizohet se Programi i studimit Master profesional në Edukim me profil “Mësimdhënie dhe të Nxënit” synon një formim profesional, bashkëkohor në këtë fushë, si dhe ofron një përgatitje tërësore, profesionale për të gjitha profilet e mësuesisë lidhur me zbatimin me efektshmëri të Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar</p> <p>(<i>Evidenca 7. Rregullore për programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional me profil “ Mësimdhënie dhe të nxënit”, neni 2/4</i>)</p>
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Universiteti “Barleti” pasuron nga viti në vit ofertën e tij akademike, duke ndërtuar programe te reja studimi bazë dhe shumëdisiplinore, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimin e dijeve bashkëkohore. Duke qenë se edukimi është një nga fushat prioritare të këtij universiteti, Departamenti i Edukimit dhe Trajnimit Profesional me masterin “Mësimdhënie dhe të Nxënit” ka mundur të përputhjen e emërtimit, organizimit dhe përmbajtjes së programit me fushën dhe drejtimin akademik të institucionit.</p> <p><i>Evidenca 2. Statusi i Universitetit “Barleti”, Formimi multidisiplinor dhe aftësitë “soft”</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.</p>	<p>Ky program studimi është në përputhje të plotë me strategjinë kombëtare të zhvillimit, interesin kombëtar dhe trendet globale, të pasqyruara këto në dokumentacionin e Universitetit Marin Barleti.</p> <p><i>Evidenca 2. Statusi i Universitetit “Barleti”; Evidenca 3 Strategjia e Zhvillimi Institucional; Evidenca 7. Rregullore për</i></p>



Gueto

	<i>programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional me profil “ Mësimdhënie dhe të nxënit”</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi Master në profilin “Mësimdhënie dhe të Nxënit” në objektivat e tij synon të përmbushë qëllimin e tij që lidhet “me përgatitjen e mësuesve të aftë në çështjet e mësimdhënies dhe nxënies, mësues të efektshëm, praktikientë reflektivë që nxënë gjatë gjithë jetës”.(Plani strategjik për programin MP në MNX, faqe 4)</p> <p>Në objektivat e programit synohet që studentët të fitojnë kompetencat e duhura, profesionale të planifikimit dhe zhvillimit të kurrikulës, bazuar në kompetencat kyçe evropiane, të teorive dhe praktikave më të mira të mësimdhënies dhe të nxënit, të metodologjive ndërvepruese dhe atyre të nxitjes së të menduarit kritik, sipas filozofive më të suksesshme të edukimit, por dhe njohje të thelluar të veçorive psikologjike të fëmijëve, të adoleshentëve dhe të rriturve, etj. (Evidenca 4. Plani strategjik për programin MP në MNX)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të</p>	<p>Programi MP në MNX është i mbështetur në hapjen dhe vazhdimin e tij në studimin përkatës që identifikon nevojat e thellimit të kompetencave profesionale në fushën e mësuesisë, për një cilësi më të lartë të sistemit arsimor parauniversitar dhe përgatitjen e studentëve me parametra kombëtarë dhe ndërkombëtarë për tregun e punës</p> <p>(Evidenca 16. Studimi për tregun e punës para hapjes së programit)</p>

diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	
Kriteri 3. Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	Numri i studentëve të punësuar pas daljes nga programi MP në fushën e mësuesisë është ndër më të lartët, (68 %) krahasuar me programet e tjera që ofron universiteti “Barleti”, gjë që tregon se dijet, aftësitë, shkathtësitë dhe kompetencat e fituara në këtë program i përgjigjen tregut të punës <i>(Evidenca 17. Studim për tregun e punës pas daljes të studentëve)</i>
Kriteri 4. Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.	Ky program studimi është i përafërt apo i ngjashëm me disa programe të tjera studimi, të ofruara në universitete të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare duke u dhënë mundësi studentëve që përfundojnë MP në MNX, jo vetëm të lehtësojnë procesin e transferimit të studimeve të tyre, por edhe të punësohen në të ardhmen në tregun ndërkombëtar. Ngjashmëria në përmbajtje dhe organizimi shkon deri në masën 80 %, të orientuar nga Procesi i Bolonjës. <i>(Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve)</i>
Kriteri 5. Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikatat e mira të vendeve evropiane.	Programi MP në profilin “Mësimdhënie dhe të nxëniet” është i mbështetur në legjislacionin dhe direktivat e BE për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, gjë që shprehet në të gjithë dokumentacionin e UniBa. (<i>statut, rregullore, Plan zhvillimi strategjik, etj</i>)
Kriteri 6. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	Programi MP në profilin MNX ka një planifikim dhe organizim shumë të mirë të praktikave profesionale në raport me qëllimin dhe objektivat e programit, gjë që krijon hapësira reale të lidhjes së teorisë me praktikën, duke zhvilluar kompetenca të mira profesionale, të vlefshme për punën dhe jetën e studentëve pas futjes në tregun e punës.
Kriteri 7. Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të	Programi MP në “Mësimdhënie dhe nxënie” është munduar të përfshijë në modulet dhe lëndët e tij element të mësimdhënies në gjuhë të huaj, duke arritur kështu të ketë edhe studentë të huaj (në këtë vit akademik ka një të tillë),


Gueto

përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.	por kryesisht i ofron leksionet për studentët e tij në gjuhën amtare.			
Kriteri 8. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimit të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.	MP në “Mësimdhënie dhe të Nxënit” është riorganizuar nga një master profesional me 60 kredite në një master me 120 kredite në vitin 2018, duke përmbushur kështu plotësimin e nevojave arsimore të vendit për personel më të kualifikuar në fushën e mësimdhënies dhe të nxënit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.4	
Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Institucioni dhe veçanërisht Departamenti i Edukimit dhe Trajnimit profesional që mbulon masterin profesional “Mësimdhënie dhe të nxënit” i ka të gjitha burimet e duhura për zhvillimin cilësor të këtij kursi që ofron. Personeli akademik i departamentit përbëhet nga 17 pedagogë gjithsej, prej të cilëve 10 janë staf akademik efektiv (PAE) dhe 7 janë me kontratë (PAK). Përgatitja e tyre akademike i referohet lektorëve me këto grada dhe tituj: 1 profesor i asociuar, 10 me gradën doktor i shkencave dhe 6 me master i shkencave. Këta të fundit operojnë në fushën e praktikave profesionale, IT, etj. <i>Evidenca 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike kërkimore të Departamentit të Edukimit dhe Trajnimit profesional, që është dhe njësia përgjegjëse për programin e studimit. Shihet të jenë respektuar të gjitha direktivat dhe udhëzimet kombëtare dhe evropiane në klasifikimin/ kodifikimin e këtij programi.


direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.				
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit Master Profesional, sikurse u përmend më sipër është në përputhje me fushën akademike të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit dhe që në këtë rast është Departamenti i Edukimit dhe Trajnimit profesional duke iu përgjigjur kërkesave dhe udhëzimeve kombëtare dhe evropiane.			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Programi i ciklit të dytë Master profesional është brenda profilit të institucionit dhe cilësia e tij garantohet nga vetë Departamenti Edukimit dhe Trajnimit profesional, që shihet të jetë me përvojë dhe arritje të dukshme në punën e tij. Ka një harmoni me fushën e shkencave shoqërore dhe në linjë me profilin e njësisë bazë që ofron programin e studimit “MP në “Mësimdhënie dhe të Nxënit”.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes	Institucioni ka një dokumentacion të plotë për hartimin dhe mbikëqyrjen e mbarëvajtjen e programit. Në të përshkruhen qartë detyrat e secilit anëtar të Departamentit të Edukimit dhe Trajnimit profesional, përgjegjësitë respektive dhe analiza e vazhdueshme e punës së gjithsecilit.



Gueta

<p>së detyrave mes njësisive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit MP në MNX,</i> <i>Evidenca 8. Rregullore e zhvillimit të kurrikulës</i> <i>Evidenca 34. Marrëveshje bashkëpunimi me institucione, . etj)</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Në përmbushjen e këtij kriteri, institucioni ka një marrëveshje bashkëpunimi me shkollën jopublike “Elitë” ku shihet se janë të përcaktuara qartë detyrat e secilit aktor. UniBa merr përsipër: përgatitjen e paketës/ sigurimin e pedagogut mentor / ndihmën e nevojshme për studentët praktikantë/ ndjekjen e punës së studentëve dhe vlerësimin e studentëve për paketën e praktikës. Shkolla “Elitë” merr përsipër: mundësimin e zhvillimit të praktikave në këtë institucion duke firmosur marrëveshjen/ caktimin e një mbikëqyrësi të studentëve/ vënien në dispozicion të materialeve dhe mjeteve ndihmëse për zhvillimin profesional të studentëve/ angazhimin e studentëve praktikantë sipas nevojave të institucionit/ dhënien e mendimeve për vlerësimin e studentëve praktikantë. <i>(Evidenca 34. Marrëveshje bashkëpunimi me institucione, faqe 2 dhe 3)</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Departamenti i Edukimit dhe Trajnimit profesional ka të nënshkruar marrëveshjen me shkollën jopublike “Elitë” për realizimin e praktikës mësimore të këtij masteri profesional, marrëveshje kjo e përsëritur në periudhën kohore të funksionimit të Masterit profesional “Mësimdhënie dhe të nxënit”. <i>(Evidenca 34. Marrëveshje bashkëpunimi me institucione)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.</p>	<p>Sikurse u përmend në kriterin 2 të këtij standardi, universiteti “Marin Barleti” ka të nënshkruar marrëveshjen me shkollën jopublike “Elitë”, duke krijuar kështu marrëdhënie zyrtare dhe bashkëpunim me punëdhënësin për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programit të studimit Master Professional në “Mësimdhënie dhe të nxënit”. Marrëveshja është e përcaktuar në detaje për detyrat dhe angazhimet e secilës palë. Ekzistojnë edhe një sërë marrëveshjesh të tjera si me shkollat publike “Jeronim De Rada”, “Musa Cakëri”, “Arbëria”, “Sarina 2002”, “Bajram Curri” etj, me vendndodhje jo vetëm në Tiranë, por edhe në</p>

	rrethe. (Institucione bashkëpunuese, faqe 1; Evidenca 34. Marrëveshje bashkëpunimi me institucione)			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	<p>Departamenti i Edukimit dhe Trajnimit profesional në universitetin “Marin Barleti” dallohet në veçanti për një përvojë të pasur në trajnimin e mësuesve të diplomuar dhe angazhimin e një sërë aktiviteteve që synojnë jo vetëm trajnimin e mësuesve, drejtuesve të shkollave, por edhe bashkëpunimit me institucione të tjera për çështje të ndryshme të cilësisë së arsimit në vend.</p> <p><i>GVJ rekomandon angazhim më të madh të pedagogëve në njohjen e mësuesve të shkollave të ndryshme me vlerat e këtij programi studimi nëpërmjet trajnimeve, konferencave, etj.</i></p> <p>(Evidenca 33. Tabelë përmbledhëse për trajnimin profesional,)</p>			
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	<p>Njësia përgjegjëse për Programin e studimit Master profesional në profilin “Mësimdhënie dhe të nxënit” realizon me korrektësi hartimin e raporteve analitike të bashkëpunimit me institucionet në funksion të programit të studimit</p> <p>Evidenca 37. Raporte vjetore të publikuara për monitorim;; Evidenca 38. Analiza e Departamentit të Edukimit dhe Trajnimit profesional në MP, “Mësimdhënie dhe të nxënit”, Evidenca 11. Rregullore për vlerësimin dhe Administrimin e Performancës.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin	Programi i ciklit të dytë Master Profesional në “Mësimdhënie dhe të Nxënit” është ndërtuar referuar nivelit 7 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. Pas riorganizimit të bërë në vitin 2018, ky program realizohet me 120 kredite dhe me kohëzgjatje

<p>vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>normale 2 vjet. Programi i pajis të diplomuarit me njohuri të thelluara profesionale në fushën e mësimdhënies dhe nxënies për të gjitha profilet e mësuesisë. Programi i studimit është i modularizuar. Në përputhje me ngarkesën e studentëve nga orët e prezencës në mësim, studimi individual, praktika dhe provimet, për modulet jepen pikët ECTS sipas sistemit evropian të transferimit të krediteve.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit MP, në MNX</i></p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>Programi ka si synim të tij: Të formojë kompetenca për të përmbushur efektivisht rolet e ndryshme të mësuesit në të gjitha ciklet e shkollimit si planifikues, zbatues i kurrikulës, përdorues i metodologjive me në qendër nxënien, i teknikave dhe i formave të vlerësimit formues dhe matës, si dhe i TIK në fushën e mësimdhënies dhe nxënies; të zhvillojë aftësi të kërkimit shkencor në fushën e mësimdhënies dhe nxënies; të zhvillojë aftësi për reflektim dhe zhvillim profesional në këtë fushë, etj</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit MP, në MNX</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi i studimit MP në MNX i përgatit studentët me njohuri të thelluara profesionale në fushën e mësimdhënies dhe të nxënies për profilet e ndryshme të mësuesisë. Duke tentuar të realizohet formimi i mësuesve si ekspertë metodologjikë në mësimdhënie dhe nxënie, programi i studimit përfshin lëndë si Psikologjia e zhvillimit njerëzor; Gjithëpërfshirja në shkollë; Hartimi dhe zbatimi i kurrikulës; Teoritë e të nxënies dhe modelet e mësimdhënies; Diversiteti i nxënësve në klasë; Menaxhimi i klasës; Metoda të kërkimit në edukim; TIK në mësimdhënie dhe të nxënësve; Vlerësimi për të nxënies dhe i të nxënies; Edukimi dhe bashkëpunimi me prindërit; Kompetencat kyçe evropiane për arsimin; Aftësitë dhe temat ndërkurrikulare në arsimin parauniversitar; Politika dhe ligjshmëria në arsim; Drejtimi dhe menaxhimi i institucionit arsimor si dhe zhvillimin e praktikave profesionale. Në këtë mënyrë sigurohet kulturë e përgjithshme pedagogjike dhe psikologjike e studentëve, por edhe ekspertizë e ngushtë profesionale në aspekte të caktuara që lidhen me mësimdhënien dhe të nxënies.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit MP, në MNX. Evidenca 14. Plani mësimor i programit të studimit MP me profil "Mësimdhënie dhe të nxënies" Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve.</i></p>
<p>Kriteri 4 Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të</p>	<p>Lëndët me zgjedhje dhe profile të programit janë paketa lëndësh të cilat me brendinë e tyre:</p>



Gueto

<p>avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>a. ofrojnë formim të specializuar në një drejtim ose fushë që mund të jetë komplementare ose jo me formimin bazë;</p> <p>b. I garantojnë formimit një hapësirë më të madhe zbatimi, duke rritur mundësinë për përshtatjen dhe integrimin në tregun e punës, etj</p> <p>Lëndë me zgjedhje në këtë program studimi janë konkretisht: Kompetencat kyçe evropiane për arsimin; Aftësitë dhe temat ndërkurrikulare në arsimin parauniversitar; Politikat dhe ligjshmëria në arsim apo Drejtimi dhe menaxhimi i institucionit arsimor</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit MP, në MNX</i></p>
<p>Kriteri 5 Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Lëndët që zhvillohen në këtë program studimi grupohen në kategoritë si vijon:</p> <p>a. lëndë bazë që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme;</p> <p>b. lëndë karakterizuese që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe që japin një formim specifik sipas karakteristikave të tij;</p> <p>c. lëndë disiplinore ose integruese në një ose më shumë disiplina të ngjashme ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup- lëndësh me zgjedhje;</p> <p>d. lëndë plotësuese, të fokusuar në përfitimin e aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike dhe telematike, aftësive komunikuese dhe prezantuese, aftësive që lejojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikat profesionale të zhvilluara pranë subjekteve publike dhe private me të cilat realizohen marrëveshjet.</p> <p><i>(mbështetur në akte ligjore dhe nënligjore për ndërtimin e strukturës së programit të studimit)</i></p>
<p>Kriteri 6 Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Mësimdhënie dhe të nxëniti” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke i grupuar lëndët sipas modelit të dhënë më sipër dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p> <p><i>Evidenca Plani mësimor i programit të studimit MP në Edukim me profil “Mësimdhënie dhe të nxëniti”</i></p>
<p>Kriteri 7 Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të</p>	<p>Programi i studimit ka të parashikuar ngarkesën në kredite të praktikës profesionale (7 kredite) në ekuivalentim sipas</p>



dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.	përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane <i>Evidenca Plani mësimor i programit të studimit MP në Edukim me profil "Mësimdhënie dhe të nxënit",</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyshet	Përmbyshet pjesërisht	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit, si njësi kryesore e organizuar sipas ligjeve për organizimin akademik dhe administrative të institucioneve të arsimit të lartë ka si pjesë të saj njësinë bazë përgjegjëse, Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional. Gjatë takimit me përgjegjësin e Departamentit, u konstatua se njësia bazë ngrë grupin e vlerësimit të brendshëm për këtë program studimi sipas detyrimeve ligjore për funksionimin normal të tij, si dhe në linjë me statutin dhe rregulloren e institucionit. Kjo njësi përmbush kushtet për vijimin e procesit të vlerësimit dhe akreditimit për këtë program studimi, duke iu referuar ndjekjes së procedurës pranë ASCAL duke respektuar ligjet në fuqi.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportitka në përbërje katër departamente; <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional; 2. Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve; 3. Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit; 4. Departamenti i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit; <p>Stuktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë kryesore dhe asaj bazë që është përgjegjëse për programin e studimit, janë të përcaktuara në statutin e institucionit dhe janë në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë. Dekani i Fakultetit mban titullin akademik "Profesor" ndërsa</p>

Guota

	<p>Përgjegjësi i Departamentit ka gradën shkencore, “Prof.As.”.</p> <p><i>(Evidenca 2 Statusi i Universitetit Barleti)</i></p>										
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit në vitin akademik 2021 -2022, ka në përbërje të tij 87 pedagogë gjithsej, ndër të cilët, 44 janë staf akademik efektiv (PAE), nga ku 23 me grada / tituj, dhe 43 staf akademik me kontratë, (PAK), nga ku 17 me grada / tituj.</p> <p>Ndërsa Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesionalqë është përgjegjës për programin e studimit ka në përbërje 17 pedagogë gjithsej konkretisht:</p>										
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënljore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th><u>PAE:</u></th> <th><u>PAK:</u></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1 Prof. Asoc.</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>3 Dr./PhD</td> <td>7 Dr./PhD</td> </tr> <tr> <td>6 Msc</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>10 PAE</td> <td>7 PAK</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Evidenca 23. Të dhëna tabelore për stafin akademik;</i></p> <p>Për sa më sipër GVJ konstaton se Njësia kryesore (FSHST) dhe njësia bazë përgjegjëse për programin, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënljore për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik; - organizimin dhe strukturën akademike; <p><i>Referuar sistemit AMS të ASCAL</i></p> <p><i>Evidenca 23 Te dhena tabelore per personelin akadm</i></p>	<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>	1 Prof. Asoc.	-	3 Dr./PhD	7 Dr./PhD	6 Msc	-	10 PAE	7 PAK
<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>										
1 Prof. Asoc.	-										
3 Dr./PhD	7 Dr./PhD										
6 Msc	-										
10 PAE	7 PAK										
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.</p>	<p>Për realizimin e praktikave mësimore, njësia përgjegjëse ka si staf me kohë të plotë, ashtu edhe me kohë të pjesshme. Shkolla “Elitë” me të cilën ka marrëveshje bashkëpunimi ofron mësues të saj në realizimin e praktikave mësimore</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit MP, në MNX;</i></p> <p><i>Evidenca 34. Marrëveshje bashkëpunimi me institucione</i></p>										
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili</p>	<p>Dr A Q është koordinorja e programit të studimit MP në MNX, e caktuar që në vitin 2018 me riorganizimin e këtij programi studimi e cila ka në detyrat e saj përgjegjësinë për</p>										

Qweto

është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe të praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij <i>Evidenca 7. Rregullore e programit MP, në MNX;</i> <i>Evidenca 23. Të dhëna tabelore për stafin akademik</i>			
Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.	Detyrat e koordinatorit të Departamentit apo të programit të studimit zënë një vend të rëndësishëm në rregulloren e UniBA, si me drejtuesin e njësisë përgjegjëse, ashtu edhe me stafin akademik, studentët dhe sekretarinë mësimore të institucionit. Departamenti ka të dokumentuar raporte dhe procesverbale që lidhen me raportimet periodike lidhur me programin e studimit. <i>Evidenca 11. Rregullore për vlerësimin dhe administrimin e Performancës mësimore,</i> <i>Evidenca 5. Rregullore e UniBA, neni 25, faqe 12, etj)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Departamenti i Edukimit dhe Trajnimit profesional si njësi bazë ka dokumentacion të plotë për programin MP në MNX duke filluar nga shkresa që autorizon hapjen e programit pas aplikimit deri në miratimin e riorganizimit të programit në vitin 2018. Si njësi bazë, ky departament disponon rregulloren e programit, plan- programin, të dhënat për stafin akademik, ngarkesën mësimore, numrin e studentëve të regjistruar, shërbimet që u jepen atyre, informacion për punësimin e studentëve të diplomuar, raporte të monitorimit të performancës, etj Organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit janë dhënë të plota dhe me të gjitha detajet e duhura në këtë dokumentacion.
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese,	Programi MP në MNX është i organizuar në lëndë, module, praktikë dhe aktivitete formuese në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Shqyrtimi i dokumentacionit

në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	duke filluar nga rregullorja e MP dhe deri tek sylabuset vërtetojnë një gjë të tillë. <i>Evidenca 7. Rregullore e programit MP, në MNX;</i> <i>Evidenca 14. Plani mësimor i programit të studimit MP në MNX ;Evidenca 8. Rregullore e zhvillimit të kurrikulës;</i> <i>Evidenca 19. Sylabuset e lëndëve;</i>
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Kohëzgjatja normale e programit të studimit është 2 vite akademike. Programi realizohet në 4 semestra. Programi i studimit është i modularizuar. Pikët ECTS që duhen fituar janë përcaktuar në planin mësimor (kurrikula). <i>Evidenca 7. Rregullore e programit MP, në MNX;</i> <i>Evidenca 14. Plani mësimor i programit të studimit MP në MNX</i>
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Plani mësimor i programit të studimit MP në MNX jep informacionin e nevojshëm për orët e leksioneve në auditor, orët e seminareve në auditor (detyra kursi, projekte, etj), orët jashtë auditorit, si dhe orët për studim individual. Rregullorja e programit jep informacion për frekuentimin; ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe gjithçka tjetër që është në interes të njohjes së thelluar të programit të studimit. <i>Evidenca 7. Rregullore e programit MP, në MNX;</i> <i>Evidenca 14. Plani mësimor i programit të studimit MP në MNX</i>
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Rregullorja e programit të studimit MP në MNX përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Kjo rregullore mësimore e programit të studimit është hartuar në përputhje me objektivat e programit përkatës të studimit, me planin e tij mësimor si dhe me veprimtaritë mësimore të tij. Institucioni përmes njësive të tij monitoron respektimin e kritereve të përgjithshme dhe specifiketë pranimit në këtë program studimi. <i>Evidenca 7. Rregullore e programit MP, në MNX;</i>
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (sylabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda	Janë një sërë dokumentesh që përmbajnë informacionet e nevojshme për sylabuset lëndore, për praktikat dhe seminarët, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara <i>Evidenca 7. Rregullore e programit MP, në MNX;</i> <i>Evidenca 19. Sylabuset e lëndëve;</i>

dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	<i>Evidenca A. Paketa e provës finale;</i> <i>Evidenca 14. Plani mësimor i programit të studimit MP në MNX;</i> <i>Evidenca 8. Rregullore e zhvillimit të kurrikulës</i>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Nga shqyrtimi i detajuar i dokumentacionit vërehet se përmbajtja e programit të studimit MP në MNX është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm, duke filluar që nga riorganizimi i programit dhe deri tek ndryshimet në masën 20 % (kufi i përcaktuar me akte udhëzuese për përmirësimet kurrikulare) të cilat miratohen në fillim të çdo viti akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar me 120 kredite (60 kredite për semestër) dhe 3000 orë mësimore për dy vite akademike, shpërndarë në orë leksionesh dhe seminaresh brenda dhe jashtë auditorit, orë studimi individual, etj në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Është ligji nr 80, datë 17,09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe <i>neni nr 83, pika 2</i> që përcakton se programet master të mësuesisë duhet të jenë me 120 kredite. <i>Evidenca 14. Plani mësimor i programit të studimit MP në MNX</i>
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave është bërë e studiuar për të motivuar thellimin në njohuritë dhe aftësitë e nevojshme, si dhe për të lejuar dhe lehtësuar punësimin e studentëve, gjë që konfirmohet edhe nga përqindja e lartë e tyre në punë.
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e	Shpërndarja e ngarkesës mësimore për studentët në dy vite dhe 4 semestra, vlerësimi në 60 kredite për vit dhe 30 kredite


semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënërit dhe aftësimin profesional.	për semestër dhe planifikimi i studiuar i orëve mësimore mundëson arritjen e objektivave të programit të studimit MP në MNX, duke marrë kështu rezultatet e pritshme të të nxënërit dhe aftësimin profesional. Ngarkesat janë konform kërkesave ligjore.
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Programi i studimit MP në MNX është hartuar mbështetur në përvojat më të mira evropiane dhe vendase në fushën e mësuesisë, struktura, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori - praktikë në fushën e mësimdhënies dhe nxënies është në përputhje me profilin e këtij program master dhe i përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. <i>Evidenca 7. Rregullore e programit MP, në MNX;</i> <i>Evidenca 19. Sylabuset e lëndëve;</i> <i>Evidenca 14. Plani mësimor i programit të studimit MP në MNX;</i> <i>Evidenca 8. Rregullore e zhvillimit të kurrikulës,</i>
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Planifikimi i veprimtarive të ndryshme formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik ndihmojnë arritjen e objektivave të planit mësimor të programit të studimit MP në MNX; i ngjashëm me programe të tjera studimi në vend dhe në Evropë, ndjekja dhe diplomimi në këtë program mundëson transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin në përfundim të studimeve. <i>Evidenca 14. Plani mësimor i programit të studimit MP në MNX,</i> <i>Evidenca 19. Sylabuset e lëndëve;</i>
Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Departamenti përpiqet dhe ka arritur të përditësojë lëndët dhe modulet në mënyrë të vazhdueshme, duke shtuar listën e literaturës së detyruar dhe ndihmëse në bibliotekat e institucionit, por edhe duke pasur si prioritet të vetin furnizimin e tyre me literaturë të 5 viteve të fundit. <i>Evidenca 45. Lista e teksteve në Bibliotekë</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.	Përmbajtja e programit të studimit MP në MNX krijon hapësirat e nevojshme për aftësi dhe kompetenca të thelluara profesionale në fushën e mësuesisë duke përgatitur vizionarë dhe operatorë të aftë në rritjen e cilësisë së arsimit parauniversitar.
Kriteri 8. Organizimi i programit të studimit siguron	Riorganizimi i programit të studimit MP në MNX jo vetëm e plotësoi programin e studimit nga 60 në 120 kredite, por mundësoi pasurimin e këtij program me aftësi, kompetenca

aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	dhe formim të thelluar profesional. Shtimi i lëndëve të reja, rishikimi dhe përmirësimi i sylabuseve ekzistuese me koncepte dhe njohuri bashkëkohore ka shtuar vlerën e programit të ciklit të dytë MP në MNX.			
Kriteri 9. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi MP në MNX është një program që ndikon në rritjen e cilësisë në arsimin parauniversitar; ai krijon mundësi për vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e tregut të punës, që sa vjen e më tepër kërkon mësues kompetentë për të garantuar edukimin e brezit të ri në arsimin parauniversitar <i>Evidenca 14. Plani mësimor i programit të studimit MP në MNX,</i> <i>Evidenca 19. Sylabuset e lëndëve;</i> <i>Evidenca 8. Rregullore e zhvillimit të kurrikulës</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5											
Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.											
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve										
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	<p>Departamenti i Edukimit dhe Trajnimit profesional që mbulon masterin profesional “Mësimdhënie dhe të nxënit”ka një personel që mundëson zhvillimin cilësor të këtij programi.</p> <p>Referuar dokumentave që kërkuam gjatë vizitës në institucion rezulton se stafi i angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për gjatë dy viteve akademike është si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020 janë të angazhuar 9 pedagogë gjithsej ndër të cilët 7 PAE dhe 2 PAK (78% / 22%).</p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <thead> <tr> <th style="text-align: center;"><u>PAE:</u></th> <th style="text-align: center;"><u>PAK:</u></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td style="text-align: center;">1 Prof. Dr.</td> <td style="text-align: center;">-</td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;">1 Prof. Asoc.</td> <td style="text-align: center;">-</td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;">4 Dr./PhD</td> <td style="text-align: center;">2 Dr./PhD</td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;">1 Msc</td> <td style="text-align: center;">-</td> </tr> </tbody> </table>	<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>	1 Prof. Dr.	-	1 Prof. Asoc.	-	4 Dr./PhD	2 Dr./PhD	1 Msc	-
<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>										
1 Prof. Dr.	-										
1 Prof. Asoc.	-										
4 Dr./PhD	2 Dr./PhD										
1 Msc	-										

Gueta 

	<table border="1"> <tr> <td>7 PAE</td> <td>2 PAK</td> </tr> </table> <p>Për vitin akademik 2020-2021 janë të angazhuar 9 pedagogë gjithsej ndër të cilët 7 PAE dhe 2 PAK (78% / 22%).</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th><u>PAE:</u></th> <th><u>PAK:</u></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>1 Prof. Asoc.</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>5 Dr./PhD</td> <td>2 Dr./PhD</td> </tr> <tr> <td>1 Msc</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>7 PAE</td> <td>2 PAK</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Evidenca 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik</i> <i>Tabela ASCAL, Stafit Akademik i Departamentit Dhe Programit MP, MNX.</i></p>	7 PAE	2 PAK	<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>	-	-	1 Prof. Asoc.	-	5 Dr./PhD	2 Dr./PhD	1 Msc	-	7 PAE	2 PAK
7 PAE	2 PAK														
<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>														
-	-														
1 Prof. Asoc.	-														
5 Dr./PhD	2 Dr./PhD														
1 Msc	-														
7 PAE	2 PAK														
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Kualifikimet e stafit të angazhuar në realizimin e programit të studimit janë me parametra cilësorë, ata janë të njohur në fushat e lëndëve dhe moduleve që mbulojnë duke iu përgjigjur kështu kërkesave për një drejtim cilësor të programit të studimit.</p> <p>Për sa i përket kualifikimeve të personelit akademik rezultojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për 2019-2020, 89% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 11% janë Msc; - Për 2020-2021, 89% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 11% janë Msc; <p><i>Evidenca 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik;</i> <i>Evidenca 20. CV të stafit akademik</i></p>														
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Përzgjedhja e pedagogëve në lëndët dhe modulet përkatëse të programit të studimit MP në MNX është bërë në përputhje me specializimet e tyre brenda dhe jashtë vendit. Po ashtu janë marrë në konsideratë kërkimet e tyre shkencore dhe përvojat aktive në fusha të caktuara. Kontributi i tyre me botime, manual, etj u ka dhënë mundësi të konkurrojnë brenda departamentit në mbulimin e natyrës dhe specifikës së moduleve të programit. <i>Evidenca 20. CV të stafit akademik</i></p>														
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues</p>	<p>Institucioni “Barleti” ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me kompani dhe shkolla të arsimit parauniversitar në të gjithë vendin. Kryesisht departamenti ka një marrëveshje bashkëpunimi me shkollën jopublike “Elitë” ku shihet se janë</p>														

Gueto 

<p>biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>të përcaktuara qartë detyrat e secilit aktor. UniBa merr përsipër: përgatitjen e paketës/ sigurimin e pedagogut mentor / ndihmën e nevojshme për studentët praktikantë/ ndjekjen e punës së studentëve dhe vlerësimin e studentëve për paketën e praktikës. Shkolla “Elitë” merr përsipër: mundësimin e zhvillimit të praktikave në këtë institucion duke firmosur marrëveshjen/ caktimin e një mbikëqyrësi të studentëve/ vënien në dispozicion të materialeve dhe mjeteve ndihmëse për zhvillimin profesional të studentëve/ angazhimin e studentëve praktikantë sipas nevojave të institucionit/ dhënien e mendimeve për vlerësimin e studentëve praktikantë.</p> <p>Evidenca 34. <i>Marrëveshje bashkëpunimi me institucione;</i> Evidenca 32/ a. <i>Tabelë përmbledhëse me institucione bashkëpunuese</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Edukimit dhe Trajnimit profesional ka punonjës ndihmës në realizimin e programit të studimit MP në MNX në përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve teknologjike mësimore. Kontributi i tyre ka konsistuar në ndihmën e dhënë pedagogëve dhe studentëve, veçanërisht gjatë periudhës së pandemisë dhe mësimin online.</p> <p>Evidenca 42. <i>Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit të studimit</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.6</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e</p>	<p>Bordi i Karrierës është një aktor i rëndësishëm në ndihmesën që jep edhe në programet e studimit që mbulojnë nga Departamenti i Edukimit dhe Trajnimit profesional. Veprimtaria e bordit të karrierës realizohet në funksion të integritetit të studentëve në tregun e punës. Bashkëpunimi mes Departamentit dhe Bordit, konsiston në përmirësimin e</p>




bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	kurrikulës dhe organizimin e praktikave profesionale në mënyrë që studentët të përfitojnë sa më shumë nga kërkesat e tregut të punës.			
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	Institucioni inkurajon takime të shpeshta me Bordin e karrierës dhe zyrën Alumni për të përfshirë sa më shumë student në diskutimin e programit të studimit dhe duke marrë prej tyre mendime për ecurinë e mëtejshme të punës. Për të mbështetur përpjekjet për përmirësimin e programit të studimit realizohen dhe analizohen pyetësorët dhe përgjigjet e tyre. <i>(Pyetësori i studentëve: Pyetësori i stafit akademik dhe ndihmës akademik)</i>			
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.	Zyra e karrierës, por edhe Departamenti i Edukimit dhe Trajnimit profesional është i interesuar të mbajë kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe të punësuar në funksion të tërheqjes prej tyre të ideve dhe propozimeve të ndryshme për përmirësimin e programit të studimit. <i>(Studimi për tregun e punës pas daljes së studentëve)</i>			
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.	Programi i studimit Master Profesional në “Mësimdhënie dhe të Nxëniet” ka lindur si një nevojë e tregut të punës. Mësues që kërkojnë të rrisin cilësinë e tyre të punës apo studentë që pëlqejnë të fokusohen në specializimin e tyre në mësimdhënie dhe nxënie kanë qenë promotorët e parë të studimit të tregut të punës në hapjen e këtij programi. Diskutimet e shumta publike në nivel lokal dhe qendror me mësues dhe ekspertë të arsimit prezantojnë në aktivitete të ndryshme ide dhe vizione për përmirësimin dhe riorganizimin që i duhet programit për t’iu përgjigjur nevojave të tregut të punës. <i>(Studimi për tregun e punës pas daljes së studentëve: Rregullore e Programit të studimit MP në MNX)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Universiteti “Barleti” ka hartuar udhëzues për të gjitha drejtimet mësimore që ofron. Ky udhëzues jep direktiva të qarta për zhvillimin e kurrikulës dhe përdorimin e metodave bashkëkohore që duhen përdorur në procesin mësimor. Ai orienton për punën që duhet bërë në lidhje me hartimin e sylabuseve lëndore, përzgjedhjen e literaturës, metodat bashkëkohore, sistemin e kontrollit dhe të vlerësimit të dijeve të studentëve, këshillimin akademik dhe tutoriatin, etj. Një vend të rëndësishëm në veprimtarinë e institucionit, por veçanërisht në fushën e edukimit dhe trajnimit profesional luajnë edhe trajnimet dhe konferencat që zhvillohen në institucion. Lista e trajnimeve dhe konferencave është e gjatë; ato shërbejnë jo vetëm në funksion të rritjes së nivelit akademik të studentëve dhe pedagogëve së bashku, por edhe si inicio për kërkimin shkencor që departamenti realizon në fushën e edukimit cilësor.</p> <p><i>GVJ rekomandon angazhimin e pedagogëve në publikimin e botimeve në ndihmë të studentëve të këtij kursi.</i></p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore akademike UniBA</i></p> <p><i>Evidenca 31.1 Udhëzues për mësimdhënien dhe nxënien</i></p> <p><i>Evidenca 41.1 Lista e konferencave, Workshop dhe trajnimeve</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Rregullorja e monitorimit të cilësisë në universitetin “Barleti” bazohet në nenin 38, pikat 1, 3 dhe 46 të ligjit nr 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Kjo rregullore përcakton rregullat për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë së institucionit dhe të programeve të studimit të UniBa dhe të marrëdhënieve me strukturat e tjera brenda universitetit. Janë disa forma që institucioni përdor për vlerësimin e performancës së universitetit:</p>


	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi nga Këshilli i performancës që ngrihet nga rektori; - Vlerësimi i koordinatorit të programit përmes raportimit; - Vlerësimi i mësimdhënies në auditor që kryhet nga dekani ose përgjegjësi i departamentit lidhur me personelin akademik; - Vlerësimi i realizuar nga pedagogu i lëndës përmes analizës së pyetësorëve të studentëve; - Zhvillimi i orëve të hapura për një temë mësimore të caktuar; <p><i>Evidenca 11. Rregullore për vlerësimin dhe administrimin e performancës;</i></p> <p><i>Evidenca 13. Rregullore e zyrës së monitorimit;</i></p> <p><i>Evidenca 30. Të dhëna tabelore për angazhimin në sigurimin e cilësisë</i></p> <p><i>Evidenca 40. Vlerësimi i cilësisë. Pyetësi i studentëve:</i></p> <p><i>Evidenca 41. Formulari i vlerësimit të pedagogut</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Njësia e zhvillimit të kurrikulës dhe cilësisë është përgjegjëse për organizimin dhe përpunimin e të dhënave që dalin nga analiza e përgjigjeve të pyetësorëve që iu drejtohen studentëve në lidhje me vlerësimin e formave të mësimdhënies, vlerësimin e dijeve të tyre, duke iu dhënë mundësi për ankime dhe trajtim të tyre.</p> <p>NJZHCK organizon në mënyrë periodike pyetësorët me studentët online dhe bën të ditur për stafin akademik rezultatet që dalin pas përpunimit. Për çdo anëtar të departamentit ekzistojnë raporte individuale lidhur me performancën e secilit pedagog, por që trajtohen në mënyrë konfidenciale. Këto raportime më pas dërgohen edhe në strukturat drejtuese të UniBa. Çdo pedagog ka të drejtën të njihet me vlerësimin që iu bëhet nga studentët.</p> <p><i>Evidenca 40. Vlerësimi i cilësisë; Pyetësi i studentëve</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>NJZHCK është përgjegjëse për realizimin e pyetësorëve të studentëve online, për përpunimin e tyre dhe për shpalljen e rezultateve, qoftë në rrugë konfidenciale, qoftë në rrugë publike.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit, ndryshe nga praktikat e të kaluarës nuk shërbejnë si penalitete, por si modele që duhen përmirësuar dhe nxitur në mënyrë konstruktive. Ato i shërbejnë institucionit, departamenteve dhe vetë pedagogëve</p>

inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	për të qenë më aktivë në planet e zhvillimit strategjik të institucionit, programit të studimit dhe lëndëve të veçanta. <i>Evidenca 40. Vlerësimi i cilësisë; Pyetësi i studentëve</i> <i>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit institucional</i> <i>Evidenca 4. Plani strategjik i MP në MNX</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Universiteti shihet të ketë një përvojë të larmishme në format e mësimdhënies dhe nxënies. Leksionet, seminarët, orët e hapura, projektet, detyrat e kursit dhe esetë, praktikat profesionale mbizotërojnë në procesin mësimor.</p> <p>Kontrolli i dijeve i realizuar në mënyrë të vazhdueshme identifikon pikat e forta dhe të dobëta të transmetimit të dijeve. Në këtë program studimi që i referohet pikërisht çështjes së mësimdhënies dhe nxënies evidentohet edhe nga studentët në takimet që patëm me ta, se ata kanë mësuar shumë gjëra të vlefshme për profesionin e tyre dhe që lidhen me eliminimin e rutinës ditore siç është, zhvillimi i orës mësimore me të njëjtin format, në çdo lëndë dhe temë mësimore, duke i bërë ata të jenë krijues dhe motivues me larmishmërinë që sjellin në klasë.</p> <p>Detyrat e kursit, esetë dhe projektet që studentët prezantojnë lidhen me temat që shqetësojnë arsimin në tërësi dhe cikle shkollimi apo lëndë në veçanti. Po ashtu shihet të jenë përdorur formate të ndryshme trajnimi që lidhen me kërkesat në rritje të tregut të punës.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore akademike e UniBA</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 19. Sylabusët e lëndëve</i></p>
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke	Personeli akademik me kualifikimet që disponon është i aftë të tregojë lidhjen që ka me procesin mësimor që zhvillohet në ciklet e ndryshme të arsimit parauniversitar dhe si pasojë




<p>ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>e përvojës së pasur që ka të lidhë nevojat e studentëve me zhvillimet teorike që realizohen në auditor. Edhe detyrat e përzgjedhura flasin për oferta alternative që i bëjnë studentët të zhvillojnë projekte, të realizojnë studime rasti, të kërkojnë dhe të prezantojnë detyra komplekse ku ndërlihet mendimi kritik dhe reflektiv me veprimtarinë e përditshme mësimore. Përdorimi i teknologjisë së informacionit e ka bërë më aktiv pozicionin e studentit që përpiqet të sjellë forma alternative prezantimi të detyrave të tij.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore akademike e UniBA</i></p> <p><i>Evidenca 6. Rregullore e fakultetit</i></p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP në MNX</i></p> <p><i>Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formuese dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Institucioni mbështet kualifikimin e punonjësve të vet si brenda institucionit, ashtu edhe më gjerë. CV e stafit akademik janë të pasura me trajnime dhe pjesëmarrje në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit. Përmirësimi i kompetencave didaktike shihet të jetë fokusi i trajnimeve që organizon vetë departamenti dhe projekteve trajnuese me shkallë të gjerë siç është ai i përgatitjes së drejtuesve të shkollave. Institucioni ka mbështetur takime dhe konferenca rajonale, si dhe pjesëmarrjen e lektorëve të tij në aktivitete shkencore si konferenca, simpoziume, etj jashtë vendit.</p> <p><i>Evidenca 39. Udhëzues për metoda inovative të mësimdhënies</i></p> <p><i>Evidenca 49.a. Të dhëna të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik</i></p> <p><i>Evidenca 20. CV staf akademik</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Nga rezultatet e pyetësorëve del se stafi akademik zotëron kompetencat e duhura në mësimdhënie dhe vlerësim të nxënies së studentëve. Matja e rezultateve në mënyrë periodike ndihmon stafin në zhvillimin e një plani strategjik të programit të studimit, duke qenë konkret, me objektiva të mirëpërcaktuar si për shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, ashtu dhe për përdorimin e metodave efikase të mësimdhënies.</p> <p>Në këtë aspekt, përmes dokumentacionit të prezantuar nga institucioni shihet një interesim i vazhdueshëm i strukturave drejtuese në nivel institucioni, fakulteti, përgjegjësi departamenti dhe pedagogu për mendimet dhe opinionet e studentëve në lidhje me programin e studimit. Takime, pyetësorë, trajnime , konferenca janë format që përdoren për</p>

Caeto 



	<p>të tërhequr mendimet e tyre, vërejtjet dhe analizat që ata bëjnë në mënyrë të vazhdueshme</p> <p><i>Evidenca 39. Udhëzues për metoda inovative të mësimdhënies</i></p> <p><i>Evidenca 40. Pyetësi i studentëve</i></p> <p><i>Evidenca 38. Analiza e departamentit</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Literatura dhe shembujt e dhënë nga praktika e përditshme mësimore në cikle të ndryshme shkollore e motivojnë studentin të jetë aktiv dhe kritik në diskutimet dhe detyrat e tij, duke i dhënë kështu edhe pedagogëve rast për të reflektuar dhe përmirësuar më tej punën e tyre.</p> <p><i>Evidenca 6.1 Rregullore e departamentit</i></p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP në MNX</i></p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Institucioni përdor forma dhe metoda të ndryshme të mësimdhënies për të qenë sa më tërheqës dhe interesantë për studentët. Metodatat interaktive si biseda, debate për çështje të ndryshme arsimore, studim rasti, shikim videosh profesionale me tematikë orët e mësimi, etj janë karakteristikë e mësimdhënies në këtë program studimi.</p> <p><i>Evidenca 8. Rregullore e zhvillimit të kurrikulës</i></p> <p><i>Evidenca 19. Sylabuset e lëndëve</i></p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Puna në grup dhe puna individuale janë forma që inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, sikurse edhe studimi i rastit apo debate. Pedagogu është në pozicionin e udhëheqësit dhe këshilluesit duke ruajtur në të njëjtën kohë edhe marrëdhënien e respektit ndaj njëri tjetrit. Stafit akademik me vlerat e veta mbështet punën e studentëve duke iu dhënë atyre siguri në vete, vetëvlerësim dhe besim në punën e tyre të përbashkët. Prezantimet dhe vlerësimet në programin e studimit MP në MNX bëhen në grup dhe shtojnë edhe shkallën e bashkëpunimit si në mes të studentëve me njëri tjetrin, ashtu dhe të pedagogëve.</p> <p><i>Evidenca 6.1 Rregullore e departamentit</i></p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP në MNX</i></p> <p><i>Evidenca 4. Plan strategjik për programin e studimit MP në MNX</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				X

Gueto 

Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Universiteti “Barleti” duhet bërë një model edhe për universitetet e tjera për sa i përket hapësirave të shumta dhe të mirëpajisura që ka në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve. Kampusi i ri është projektuar si një ndërtesë moderne në shërbim të të gjithë aktorëve që janë pjesë e procesit mësimor, duke përfshirë këtu edhe punonjësit ndihmës në ruajtjen e pastërtisë dhe higjienës së nevojshme.
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.	Infrastruktura në dispozicion të procesit mësimor përbëhet nga salla leksionesh, seminaresh, të pajisura me kompjuterë, projektorë, sistem fonie dhe wireless. Po ashtu në shumë mjedise u panë edhe mjete dhe materiale të tjera të nevojshme për mësim, sipas lëndëve dhe tematikave që trajtohen. Cilësia e infrastrukturës është e nivelit më të lartë si për mësimin, ashtu edhe për praktikat e ndryshme. <i>Evidenca 42. Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit të studimit</i>
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	Personeli akademik ka mjediset e veta të punës, të pajisura me të gjithë aksesorët e nevojshëm, gjë që është siguruar edhe për studentët që shfrytëzojnë hapësira që u janë dedikuar veçanërisht atyre. Sistemi i IT është jo vetëm i pajisur me mjetet e nevojshme, por ka në dispozicion edhe një numër të mjaftueshëm specialistësh që ndihmojnë procesin e informimit dhe të lidhjes së studentëve me pedagogët e tyre, por edhe me literaturën e detyruar dhe ndihmëse që mund të aksesohet përmes internetit. <i>Evidenca 42. Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit të studimit</i>
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë dhe ndihmëse në shërbim të programit të studimit plotëson të gjitha kriteret e vlefshmërisë dhe përdorimit. Ajo gjendet si fizikisht, ashtu edhe në rrugë elektronike duke garantuar kështu një shfrytëzim të mirë të saj. Sipas intervistës që iu bë bibliotekares, literatura e këtij program studimi përbëhet nga: - Literatura bazë; - Literatura ndihmëse;

Queto 

	<ul style="list-style-type: none"> - Literatura në bibliotekë; - Literatura online; - Literatura në intranet; <p><i>Evidenca 14: Dosja e plotë e programit të studimit MN në MNX;</i> <i>Evidenca 42. Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Referuar RVB, biblioteka e institucionit “Barleti” është konceptuar në disa hapësira të cilat i dedikohen llojeve të ndryshme të literaturës. Biblioteka është ndarë në dy kampuse, ku në njërin prej tyre janë vendosur librat profesionalë që janë pjesë e bibliotekës (libra të cilët mund të arkivohen me nga një kopje për çdo titull). Kjo bibliotekë ka një hapësirë prej 27, 3 m² dhe 18 poste leximi. Një tjetër njësi e kësaj biblioteke prej 97,1 m² shërben për arkivimin e revistave shkencore, punimeve të konferencave, periodikëve të fushave të ndryshme dhe ka 50 poste leximi. Biblioteka tjetër që ndodhet në katin e parë ka një hapësirë prej 70 m² dhe ka 28 poste leximi. Kjo bibliotekë ka sërish një njësi tjetër që i atashohet asaj me sipërfaqe 40 m² dhe 18 poste leximi. Duhet të përmendim që në këtë korpus bibliotekash ekzistojnë poste me kompjuterë për ofrimin dhe aksesimin e bibliotekës digjitale të universitetit. Totali i titujve të librave në Bibliotekën e universitetit është 5.250. Menaxhimi i tyre realizohet përmes platformës online.</p> <p><i>Evidenca 42. Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit të studimit</i></p> <p><i>Evidenca 45. Lista e teksteve në bibliotekë</i></p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Biblioteka e universitetit “Barleti “ ka disa marrëveshje me biblioteka digjitale si Econ Biz; Research4Life, JStore, etj të cilat kanë krijuar mundësitë e duhura për lidhje të pedagogëve dhe studentëve me literaturën ndërkombëtare. Të tjera burime të cilat sigurojnë gjetjen e revistave, librave shkencorë, artikujve janë edhe bibliotekat digjitale si “Open dissertations”; “Springer Link” dhe “DOAJ” biblioteka këto që sigurojnë gjetjen e qindra mijëra titujve për lexuesit e fushave të ndryshme.</p> <p><i>Evidenca 42. Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit të studimit (biblioteka)</i></p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave</p>	<p>Infrastruktura e UniBa, sikurse e theksuam më sipër garanton kushte optimale, si për pedagogët, ashtu edhe për studentët. Sallat e leksioneve dhe seminareve janë gjithnjë në</p>

<p>dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>gatishmëri për të pritur studentët e programeve të ndryshme të studimit dhe i mbështetin ata si me hapësirat, ashtu dhe me pajisjet e ndryshme që janë të vendosura në çdo sallë për realizimin e diplomave apo detyrave të kursit. Laboratorët e informatikës dhe bibliotekat janë mikpritëse në të dy turnet për këdo që është i interesuar të punojë dhe lexojë.</p> <p><i>Evidenca 42. Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit të studimit</i></p>			
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Metodat e mësimdhënies si leksione, seminare, projekte, laboratorë, etj realizohen tërësisht ose pjesërisht nga pajisjet TIK në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve. Në dispozicion të platformave online apo të gjithë procesit mësimor janë vendosur edhe specialistët e IT që lehtësojnë apo trajnojnë përdoruesit në punën e tyre.</p> <p><i>Evidenca 42. Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit të studimit</i></p>			
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Pedagogët dhe studentët komunikojnë mes tyre duke marrë dhe dhënë leksione, materiale të ndryshme, detyra, duke zhvilluar teste, etj. Sistemi ‘Uni BA’ Share ka ndihmuar dhe ndihmon në vazhdimësi për një komunikim të vazhdueshëm të aktorëve të institucionit mësimor. Në këtë program studimi shihet se interneti është një pikë e fortë e ndërveprimit për prezantime, udhëzime, detyra, projekte, etj element të rëndësishëm në procesin mësimor. Studentët mund të gjejnë rezultatet e tyre të provimeve nga kudo që ndodhen nëpërmjet llogarisë personale (log in) , të mundësuar nga universiteti në sistem.</p> <p><i>Evidenca 46, Menaxhimi i sistemit të brendshëm</i> <i>Evidenca 47. Menaxhimi i sistemit të brendshëm</i></p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Studentët që arrijnë mesataren mbi 9,5 kanë të drejtën që të përzgjedhin temat e tyre të diplomave. Pedagogët udhëheqës, por edhe ata që nuk kanë një rol të drejtpërdrejtë në punimet e diplomës japin mbështetje për studentët e tyre duke orientuar, literaturën, pyetjet kërkimore, kërkimin e thelluar, etj. Studentët me mesatare nën 9,5 hyjnë në provimet finale duke u mbështetur edhe ata në punën përgatitore që duhet të bëjnë për këtë provë.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP në MNX</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Gueto 

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Në universitetin “Barleti” funksionojnë disa struktura që merren me promovimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Siç kemi përmendur edhe më lart, struktura si Komisioni për vlerësimin dhe administrimin e Performancës luajnë një rol të vlefshëm në monitorimin e vazhdueshëm të punës së departamentit në këtë program studimi. Por në shfletimin e dokumentacionit dhe intervistat e zhvilluara u vu re se një punë konstante dhe cilësore ishte bërë nga NJZVKC, e cila bashkërendon punën e saj me njësi të tjera në funksion të përmirësimit të cilësisë. Kjo njësi bashkëpunon me Zyrën e Karrierës dhe ALUMNI për realizimin e pyetësorëve me studentët, për të tërhequr mendimin e tyre në lidhje me proceset e ndryshimit në funksion të rritjes së cilësisë mësimore dhe kërkimit shkencor.</p> <p><i>Evidenca 8. Rregullore e zhvillimit të kurrikulës</i></p> <p><i>Evidenca 39. Udhëzues për përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie</i></p> <p><i>Evidenca 40. Pyetësori i studentëve</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti i Edukimit dhe Trajnimit profesional është njësia përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies, vlerësimin të arritjeve të studentëve dhe rritjes së vetëdijes si tek personeli akademik, ashtu edhe tek studentët për cilësinë e programit që ofron. Departamenti ka bërë të gjitha përpjekjet për të rekrutuar një staf cilësor, për të bërë shpërndarjen e orëve dhe lëndëve në bazë të rregullave në fuqi dhe mbi të gjitha për të pasur pedagogët me kualifikimin dhe ekspertizën e duhur në këtë program studimi. Intervistat me studentët dëshmuuan vlerësimin e tyre maksimal për punën cilësore të pedagogëve në procesin e mësimdhënies.</p> <p><i>Evidenca 37. Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë</i></p> <p><i>Evidenca 8. Rregullore për zhvillimin e kurrikulës</i></p>

	<p><i>Evidenca 38. Analizë e departamentit përgjegjës</i></p> <p><i>Evidenca 11. Rregullore për vlerësimin dhe administrimin e performancës</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Departamenti i Edukimit dhe Trajnimit Profesional ka inkurajuar nxitjen dhe motivimin e pedagogëve për zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies. Përgatitja e udhëzuesit dhe ushtrimi i këtyre metodave në praktikën konkrete të punës në institucion dhe në këtë program studimi janë një hap cilësor i angazhimit në eksperimentime dhe arritje të rezultateve të dëshiruara.</p> <p><i>Evidenca 39. Udhëzues për përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Në fushën e kërkimit shkencor, institucioni është i angazhuar plotësisht duke formuar disa qendra kërkimore si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Instituti i kërkim zhvillimit “Barleti”; - Instituti shqiptar i Çështjeve Publike; - Instituti i Edukimit “Barleti”; - Instituti ADRIAPOL, Kërkim, Zhvillim, Rritje, Inovacion; - Qendra YOUTH ACT; - Qendra EDUCATION in United States “EDUSA”; <p>Stafi akademik i universitetit është i angazhuar në punën kërkimore shkencore të këtyre qendrave duke qenë punonjës shkencorë aty dhe duke zhvilluar një punë të gjerë jo vetëm si pedagogë, por edhe kërkues të mirëfilltë.</p> <p><i>Evidenca 43.a. Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik</i></p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Institucioni ka në kujdes të vazhdueshëm trajnimin e stafit akademik dhe rritjen e shkallës së tyre kualifikuese. Projektet, botimet, shërbimet në favor të publikut jepen nga pedagogët e UniBa, pasi kualifikimi që ata kanë i ka bërë të besueshëm dhe efektivë. Specializimet e tyre brenda dhe jashtë vendit kanë kontribuar për një staf të cilësisë së lartë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.</p> <p><i>Evidenca 39. Udhëzues për përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie</i></p> <p><i>Evidenca 43.a. Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik</i></p> <p><i>Evidenca 20. CV staf akademik</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës</p>	<p>Personeli akademik dhe ai ndihmës tregojnë angazhimin e tyre në zbatimin e këtij program studimi duke rishikuar</p>

Guatp

<p>akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>sylabuset në fillim të çdo viti akademik dhe duke përmirësuar planet e punës së tyre në favor të rritjes së cilësisë. Metodot inovative që ata zbatojnë gjejnë shtrirje në punën e studentëve të tyre në cikle të ndryshme të shkollimit, por edhe në trajnimet ku stafi i institucionit është përfshirë, gjë që flet për një përhapje të përvojës pozitive të këtij universiteti në fushën e edukimit.</p> <p><i>Evidenca 39. Udhëzues për përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie</i></p> <p><i>Evidenca 43.a. Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik</i></p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Stafi i këtij program studimi dëshmon përmes dokumentacionit që disponon se zhvillon analiza, realizon raporte dhe bën diskutime të vazhdueshme për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe metodave prioritare që duhet të udhëheqin në procesin e mësimdhënies. Efektshmëria dhe rezultatet janë fokusi në të cilat përqendrohet vëmendja e stafit akademik dhe atij ndihmës.</p> <p><i>Evidenca 38. Analizë departamenti</i></p> <p><i>Evidenca 37. Raporti vjetor i departamentit</i></p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Institucioni ka përfshirë në politikat e tij bashkëpunimin me lektorë dhe ekspertë vendas dhe të huaj. Angazhimi në debate shkencore dhe shkëmbimin e ideve novatore ka bërë të mundur që institucioni të përfshijë shumë në fushat e mësimdhënies. Konferencat shkencore, leksionet e hapura dhe tryezat e diskutimeve dhe debateve janë forma që kanë nxitur stafin akademik drejt përmirësimit të metodave aktuale të mësimdhënies, duke rritur kështu dhe shkallën e kualifikimit të tyre .</p> <p><i>Evidenca 43. Të dhëna për aktivitet kërkimi shkencor</i></p> <p><i>Evidenca 43.1 Lista e konferencave, workshopeve, trajnimeve</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.5


Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve


<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit, MP në MNX, <i>neni 17</i> mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit nënvizon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kriteret dhe format e vlerësimit të studentëve përcaktohen në planin mësimor (kurrikula), në sylabusin e lëndës dhe i bëhen të ditura studentëve; 2. Vlerësimi në një lëndë mund të bëhet a. me provim me shkrim, me gojë ose i kombinuar; b. me detyra kursi, projekte dhe postera; c. i bazuar në një shumëllojshmëri formash vlerësimi; 3. Shkalla e përvetësimit të dijes nga studentët bëhet sipas sistemit me notë (notat 1 deri në 10), pikë ose me përqindje (100 pikë ose 100 %) dhe me shkronja (sipas sistemit ECTS nga A deri në F). Vlerësimi me notë është i detyrueshëm, në kuptimin që përfundimi i një vlerësimi duhet të shprehet detyrimisht edhe me notë. Nota kaluese konsiderohet nga 5 e lart, pikët nga 50 e lart, shkronjat nga E tek A; <p>Rregullorja akademike përcakton se: Vlerësimi realizohet në forma të ndryshme që lidhen me formimin formues dhe atë përfundimtar. Vlerësimi në një lëndë mund të bëhet me:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Me provim të ndërmjetëm b. Detyrë kursi c. Provim përfundimtar <p><i>Evidenca 5. Rregullore akademike</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP në MNX</i> <i>Evidenca 19. Sylabuset e lëndëve</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në sylabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Sylabusi i lëndës është një ndër dokumentet e para me të cilat njihet studenti nga pedagogu mësimdhënës. Në sylabus evidentohen mënyra e kontrollit dhe format e vlerësimit, si dhe afatet kohore për secilin detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës.</p> <p><i>Evidenca 19. Sylabuset e lëndëve .</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP në MNX</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të</p>	<p>Referuar RVB dhe dokumentacionit, vlerësimi i njohurive të studentit bëhet nëpërmjet formave të ndryshme, nëpërmjet vlerësimit formues dhe atij përmbledhës. Në format e vlerësimit të vazhduar përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> -aktivizimi më seminare; -realizimi i detyrave të kursit, projekteve, eseve;

Q. Stafa




demonstrojnë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	-Provimi ose testimi i ndërmjetëm; -Testimi përfundimtar; <i>Evidenca 5. Rregullore akademike e universitetit "Marin Barleti"</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP në MNX</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Vlerësimi është një proces i vazhdueshëm që zgjat gjatë gjithë vitit akademik, në varësi të lëndës. Vlerësimi përfundimtar nuk është një mbledhje e thjeshtë e kontrollit të dijes që ka asistuar pedagogu. Ai lidhet me frekuentimin e studentit në auditor, angazhimin aktiv të tij në seminare dhe realizimin e detyrave të ndryshme të kursit: ese, studim rasti, projekte, debate, prezantime, etj. Provimi i ndërmjetëm dhe ai përfundimtar kanë peshë në vlerësimin e studentit, krahas edhe vlerësimeve të përmendura më sipër. Pedagogu duhet të vlerësojë në mënyrë konstruktive, duke qartësuar studentët për pikët e forta dhe të dobëta që ata kanë shfaqur në përvetësimin e dijeve lëndore.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Duke pasur një bazë të mirë elektronike, Universiteti "Barleti" ka përdorur krahas testimit fizik dhe testimin elektronik që natyrisht rrisin transparencën. Prezantimi i detyrave të kursit, zhvillimi i testeve apo provimeve të ndryshme të realizuara elektronikisht kanë shoqëruar edhe testimet tradicionale me gojë. Universiteti ka përdorur disa platforma elektronike për vlerësimin si google meet, google classroom, zoom, platforma këto që kanë ndihmuar vlerësimin elektronik. <i>Evidenca 59. Mësimdhënia online UniBA(GUIDE)2020</i> <i>Evidenca 59.a. Manual i mësimdhënies online UniBA, 2020</i> <i>Evidenca 59.b. Manual i mësimdhënies online UniBA, 2021</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive,	Procedura e vlerësimit të provimeve mbështet në rregulloret që Institucioni ka të dokumentuar dhe zbaton në praktikë.

Guato 


<p>dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Provimi zhvillohet në praninë e dy pedagogëve, ku njëri është titullar dhe tjetri asistent. Si hartimi i testit përmbledhës, ashtu edhe protokollit i fletës së vlerësimit firmosen nga Përgjegjësi i departamentit.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP në MNX</i></p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Testi përmbledhës me shkrim kodohet nga sekretaria mësimore për të ruajtur anonimitetin e të dhënave identifikuese të studentit në procesin e vlerësimit. Dekodimi bëhet sërish nga sekretaria pas vlerësimit të pedagogut.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP në MNX</i></p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i vazhduar i punës së studentëve zhvillohet gjatë gjithë vitit akademik. Ata marrin komente dhe vlerësime për detyrat e kursit, projektet, diskutimet në seminare, prezantimet në Power Point, si dhe për testet formuese. Ndryshe nga këndvështrimi tradicional, këto vlerësime jepen për të nxitur studentët për të përmirësuar nxënien. Nëpërmjet vlerësimeve me gojë pedagogët u mësojnë studentëve dhe analizën SWOT, duke i bërë ata të vetëdijshëm dhe vetvlerësues të arritjeve të tyre. Pedagogët përkatës mund të zhvillojnë modele të testeve me studentët për parapërgatitje , si dhe për të sqaruar kriteret e vlerësimit.</p> <p><i>Evidenca G. Formatet e testeve</i></p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Referuar RVB salla ku zhvillohet provimi monitorohet nga departamenti dhe sekretaria. Nuk lejohet përdorimi i celularëve. Po ashtu nuk lejohet hyrja e individëve që nuk kanë lidhje me provimin. Kodi i etikës së universitetit, rregulloret e të gjitha niveleve institucionale nuk e tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore akademike e UniBA</i></p> <p><i>Evidenca 60. Kodi i Etikës</i></p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP në MNX</i></p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Meritokracia fillon që në shkollë. Universiteti duhet ta promovojë përmes prezantimeve transparente, të hapura dhe vlerësimit objektiv meritën e çdo individi për punë që bën.</p> <p>Vlerësimet e provimeve dokumentohen në fletën e vlerësimit dhe në regjistrin e arritjeve akademike. Pedagogu ka si përgjegjësi të plotësojë fletën e vlerësimit në përfundim të procesit dhe ta dorëzojë në sekretari jo më vonë se 10 ditë nga</p>

Gueta




	<p>dita e provimit ose prezantimit të detyrës. Fleta e vlerësimit firmoset nga përgjegjësi i departamentit dhe nga kryesekretari.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP në MNX, neni 28, pikat 1 dhe 2.</i></p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Pedagogu i lëndës i shpall notat në mënyrë jozyrtare para se t'i regjistrojë ato. Kjo gjë bëhet me qëllim që studentët të njihen me vlerësimin dhe t'u shpjegohet apo argumentohet nota e vendosur. Studenti ka të drejtë të diskutojë për gjykimin e pedagogut, gabimet që mund të jenë bërë prej tij dhe të kërkojë rishikim të vlerësimit, në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP në MNX. Neni 28, pika .4.3 b dhe 4.3.c</i></p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Referuar rregullores seferuar rregullores së programit, studenti mund të ankimohej me shkrim për notën e vënë brenda tre ditësh nga data e komunikimit të saj, gjithnjë para shënimit të saj në regjistrin e arritjeve akademike. Nëse pedagogu refuzon, atëherë studenti mund t'i drejtohet përgjegjësit të departamentit për të ngritur një komision rivlerësimi. Vendimi i Komisionit të Rivlerësimit është përfundimtar dhe dokumentacioni bashkë me rezultatin dorëzohet dhe arkivohet në sekretarinë mësimore.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP në MNX. Neni 28, pika .4.3.d</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.7</p> <p>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë Master në “Mësimdhënie dhe të nxënit” është një program i lidhur ngushtë me kompetencat profesionale të mësuesit. Lëndë si “Hartimi dhe zbatimi i kurrikulës”, “Teoritë e të nxënit dhe modelet e mësimdhënies”, “Menaxhimi i klasës”, “Metoda të kërkimit</p>


Gueto 

<p>profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>në edukim”, “Vlerësimi për të nxënit dhe i të nxënit”, “Kompetencat kyçe evropiane për arsimin”, “Politika dhe legjislacioni”, janë lëndë që thellojnë njohuritë profesionale duke i dhënë mundësi të gjithë studentëve të reflektojnë për pozicionin e tyre në nivelet e ndryshme të shkollimit dhe të shfaqin aftësi të veçanta profesionale. Objektivat e vendosura në këtë program studimi kanë si tipar parësor formimin e një mësuesi ndryshe nga ai i përgatitur deri tani dhe mund të themi se ky është një objektiv i arritur me sukses.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP në MNX;</i> <i>Evidenca 14: Dosja e plotë e programit të studimit MN në MNX;</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit ka të atashuar në mënyrë harmonike edhe një sërë lëndësh të kulturës së përgjithshme që e përgatisin mësuesin me kompetenca të plota edhe në fushën e TIK, shkencave humane dhe sociale, të komunikimit dhe të ndërveprimit, gjuhë të huaj, etj</p> <p>Përdorimi i TIK dhe i gjuhës së huaj i përgatit studentët të gjejnë informacione të shumta për detyrat e tyre të kursit apo prezantimet e ndryshme që duhet të bëjnë. Po ashtu shkencat humane dhe sociale i përgatisin ata me aftësi të mira komunikimi dhe njohje të thelluar psikologjike të moshës me të cilën punojnë apo do të punojnë në të ardhmen.</p> <p><i>Evidenca 14: Dosja e plotë e programit të studimit MN në MNX;</i> <i>Evidenca 60. Programi i lëndës TIK në MP “Mësimdhënie dhe të nxënit”</i> <i>Evidenca 60.a. Programi i lëndës “Metodat e kërkimit në Edukim”</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe sylabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Nga raportet vjetore dhe analizat e zhvilluara nga sektori i kurrikulës vihet re se në fillim të çdo viti akademik reflektohen ndryshime të cilat janë të lidhura me diskutimin e sylabuseve, si brenda stafit pedagogjik, ashtu edhe me studentët, në mënyrë që programi të bëhet sa më i vlefshëm dhe i plotë. Ndryshimi i kurrikulës në masën e orientuar nga ASCAL, rishikimi i sylabuseve për të përfshirë në to të rejat e shkencave të edukimit janë një element që duhet vlerësuar në punën e këtij departamenti, ku nuk mungojnë raportet e vlerësimit, analizat dhe propozimet për ndryshim në funksion të rritjes së cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 19. Sylabuset e lëndëve</i> <i>Evidenca 40. Guida për fokus grupin</i> <i>Evidenca 37. Raporte vjetore të publikuara</i></p>

Creata 

	<i>Evidenca 38. Analiza e departamentit</i>
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	<p>Sipas dokumentacionit të paraqitur, në përfundim të çdo lënde/ moduli, personeli akademik bën një përmbledhje të punës së tij, duke nxjerrë në pah pikat e forta dhe të dobëta. (Analiza SWOT). Kjo përmbledhje u shpjegohet edhe studentëve në mënyrë që edhe ata të jenë pjesë e vendimmarrjes për rritjen e cilësisë së programit, duke i ndihmuar kështu edhe për zbatimin me sukses të testit përfundimtar. Këto lloj analizash profesionale e kanë ndihmuar institucionin të përmirësojë sylabuset, cilësinë e testeve përfundimtare dhe kanë forcuar bashkëpunimi e pedagogëve me studentët në fushën e edukimit.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore akademike</i></p> <p><i>Evidenca 40. Guida për fokus grupin</i></p> <p><i>Evidenca 41. Pyetësor për stafin akademik dhe jo akademik</i></p> <p><i>Evidenca 38. Analiza e departamentit</i></p>
Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	<p>Departamenti i Edukimit dhe Trajnimit profesional ka ftuar mjaft lektorë të jashtëm që nëpërmjet leksioneve të hapura kanë dhënë ekspertizën e tyre në fusha të ndryshme të shkencës dhe teknologjisë, në fushën e edukimit, etj leksione këto ku pjesëmarrja ka qenë e dyfishtë si nga pedagogët e brendshëm, ashtu edhe studentët.</p> <p><i>Evidenca 43.1 Lista e konferencave, workshop-eve, trajnimeve</i></p> <p><i>Evidenca 33. Tabelë përmbledhëse e trajnimeve profesionale</i></p>
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	<p>Personeli akademik i Departamentit të Edukimit dhe Trajnimit profesional ka bërë të vetën punën mbi bazë kompetencash në mësimdhënie. Të gjitha sylabuset janë hartuar mbi këtë parim dhe po ashtu zhvillohet edhe një lëndë që i njeh studentët me kompetencat kyçe evropiane, bashkësi në të cilën edhe vendi ynë po kërkon të hyjë. Të mësuarit me kompetenca është një nga risitë që ky departament ka përfshirë në punën e vet profesionale. Praktika është e orientuar gjithashtu në bazë kompetencash.</p> <p><i>Evidenca 60. Programi i lëndës TIK në MP "Mësimdhënie dhe të nxënit"</i></p> <p><i>Evidenca 14. Paketa e praktikës profesionale</i></p>
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e	<p>Ngas takimi me pedagogët del se ata janë përpjekur të ndryshojnë format tradicionale të punës individuale drejt punës në grupe të vogla që nxisin bashkëpunimin, diskutimin, zgjidhjen e problematikave të ndryshme. Duke qenë se fokusi i programit të studimit është pikërisht mësimdhënia dhe të</p>

Qeato




problematikave/çështjeve të caktuara.	nxënit, ata e kanë parë me kujdes këtë aspekt që duhet të jetë karakteristikë e të gjithë mësimdhënies së institucionit. Mjediset e auditorëve janë të projektuara për një mbështetje të vazhdueshme të kësaj qasjeje.								
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Personeli akademik ndjehet se ka një klimë të shëndetshme të pranimit të ideve të reja dhe pozitive profesionale. Është një kombinim brezash në moshë ku përvoja dhe studimi i avancuar kërkimor shkencor janë të karakterizuara nga respekti i ndërsjellë, gjë që i ka bërë anëtarët e stafit akademik të këtij departamenti shumë bashkëpunues. Një rol të veçantë shihet të ketë edhe shefi i departamentit që ka ditur të menaxhojë siç duhet klimën e përshtatshme nëpërmjet tolerancës dhe respektit.								
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Takimi me studentët ishte një konfirmim i marrëdhënieve të ngushta profesionale me stafin pedagogjik. Ata nënvizuan se stafi akademik i ka mbështetur ata në të gjitha format jo vetëm për përvetësimin e ideve dhe filozofive të reja të edukimit në planin teorik, por edhe gjatë praktikës. Mbështetja për idetë inovative dhe studimet e avancuara kërkimore shkencore sipas pohimit të tyre është bërë në të gjitha aspektet, moralisht, profesionalisht dhe financiarisht.								
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Pedagogët e UniBa janë përpjekur t'i përfshijnë studentët e tyre në projektet dhe studimet e tyre për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e tyre. Në bashkëpunimet që stafi pedagogjik ka me institucione të ndryshme janë përfshirë edhe studentët e përzgjedhur prej tyre si ndihmës të këtyre veprimtarive. <i>Evidenca 62. Youth Act Erasmus +2018</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose	Departamenti i Edukimit dhe Trajnimit profesional ka marrëveshje me shkolla të ndryshme të vendit. Ato i përkasin cikleve të ndryshme të arsimit parauniversitar. Janë këto shkolla ku studentët realizojnë praktikën konkrete të vënies në

Gueto 

<p>jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>zbatim të njohurive të marra nga zhvillime teorike të ndryshme. Marrëveshjet e bashkëpunimit janë të detajuara ku secila palë, Institucioni dhe shkolla marrin përsipër përgjegjësitë e tyre për realizimin e praktikave në mënyrë sa më efektive dhe ku të dyja palët kanë përfitimet e tyre profesionale. Vlen për t'u theksuar se mjaft veprimtari praktike është e mundur të realizohen edhe në sallat e mirëpajisura të institucionit, siç janë përgatitja e mjeteve mësimore, zhvillimi i seancave të të mësuarit përmes TIK në laboratorin modern që universiteti disponon.</p> <p><i>Evidenca 11. Paketa e praktikës</i></p> <p><i>Evidenca 34. Marrëveshja me institucionet e tjera</i></p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>Për programin e studimit MP në “Mësimdhënie dhe të nxënit” Departamenti i Edukimit dhe Trajnimit profesional, ka një marrëveshje të plotë me shkollën jopublike “Elitë”, shkollë e cila njihet për rezultatet e saj cilësore që nga kopshti deri në maturën e shkollës së mesme. Shkolla, sikurse edhe universiteti është e pajisur me teknologjinë më të fundit bashkëkohore, duke iu dhënë mundësi studentëve që zhvillojnë praktikën aty të përfitojnë për të prezantuar njohuritë dhe kompetencat e tyre profesionale në të njëjtin nivel si në institucionin ku mësojnë.</p> <p><i>Evidenca 11. Paketa e praktikës</i></p> <p><i>Evidenca 34. Marrëveshja me institucionet e tjera</i></p>			
<p>Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>Praktikat u nënshtrohen të gjitha rregullave që zbatohen edhe për lëndët apo modulet e tjera. Të gjithë studentët duhet ta zhvillojnë atë dhe të marrin vlerësimet e kërkuara. Kjo nënkupton që në përfundim të vitit të dytë akademik , praktika profesionale ekuivalentohet me kreditet përkatëse, që në këtë rast janë 7 ECTS, dhe vlerësohet nga pedagogët mentorë në procesverbalet që dorëzohen në sekretari, të firmosura sikurse ndodh edhe me vlerësimin e lëndëve apo moduleve të tjera.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP në MNX</i></p> <p><i>Evidenca 11. Paketa e praktikës</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


Standardi III.9

Evidenca

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Për të fituar diplomën Master Profesional në “Mësimdhënie dhe të nxënit” student duhet të ketë siguruar 96 kredite. Studimet përmbillen me provën finale që është në trajtën e provimit të përgjithshëm të formimit. Kërkesat dhe procedurat për provën finale përcaktohen në aktet e brendshme rregullatorë.</p> <p>Prova finale mund të jetë një tezë kërkimi, një seri esesh, një projekt ose një dosje kërkimi, por e kushtëzuar nga mesatarja mund të jetë edhe një provim final. Për të fituar të drejtën e mbrojtjes së diplomës përmes një punimi, para studentit vihen dy kushte:</p> <ul style="list-style-type: none"> - -Të ketë notën mesatare mbi 9,5; - -Të ketë paraqitur me kohë projekt propozimin e tezës së kërkimit dhe të ketë marrë miratimin përkatës nga udhëheqësi shkencor dhe nga Komisioni i provës finale; <p>Kërkesat dhe procedurat e hollësishme për provën finale përcaktohen në Paketën e Provës Finale.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP në MNX</i> <i>Evidenca A. Paketa e Provës Finale</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Gjatë periudhës së diplomimit, struktura përgjegjëse dhe stafi akademik asistojnë studentët e tyre me literaturë, udhëzime, informacione dhe materiale përkatëse në funksion të provimit final apo mbrojtjes së diplomës. Ata punojnë së bashku me studentët edhe në séance të veçanta konsultimi, në se atyre iu nevojiten.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Paketa e provës finale ka në përmbajtjen e saj udhëzime për procedurat e përgatitjes, udhëheqjes, të monitorimit, të prezantimit dhe të vlerësimit të punimit të provës finale. Po ashtu në paketë janë renditur përgjegjësitë e secilës palë që përfshihet në realizimin e kësaj veprimtarie. Komisioni i vlerësimit të provës finale e mbështet punën e tij në procedurat e hollësishme të Paketës së provës finale. Kjo paketë i shërben si pedagogëve, ashtu edhe studentëve.</p> <p><i>Evidenca A. Paketa e Provës Finale</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP në MNX</i></p>

<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.</p>	<p>Personeli akademik i programit të studimit MP në MNX ka gjithnjë në gatishmëri orientuese një fond pyetjesh dhe temash që duhet të studiohen për provën finale. Po ashtu, ky staf mësimor dërgon për orientim tema punimesh, nga të cilat studentët përzgjedhin atë çka është në interesin e tyre kërkimor.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Studentët që kanë fituar të drejtën për të bërë një tezë kërkimi (ata që kanë vendim senati, që përfunduar studimet me mesataren mbi 9,5 dhe që kanë paraqitur në kohën e duhur platformën e kërkimit të tyre) udhëhiqen nga një pedagog me gradën shkencore “Doktor” gjatë gjithë kërkimit të tyre. Ndihma u jepet si me material të ndryshme, ashtu dhe me mbështetjen për ngritjen e pyetjeve kërkimore, trajtimin e tyre, matjeve, etj që nevojiten për të kompletuar punimin.</p> <p><i>Evidenca A. Paketa e Provës Finale</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP në MNX</i></p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Roli i udhëheqësit shkencor është i përshkruar me detaje në rregulloren akademike të UniBa. Udhëheqësi asiston studentin e tij në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre statistikor, shkrimin e temës , formatin, etj. Ai bëhet garant për punimin dhe cilësinë e rezultateve të nxjerra gjatë kërkimit duke referuar përpara Komisionit të Provës Finale nëse punimi është i plotë ose jo.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullorja e UniBA</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Referuar procedurës së diplomimit, (provim ose mbrojtje diploma) studenti që përfundon MP në MNX vlerësohet me notë dhe me kredite.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP në MNX</i></p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomë dhe suplementin e saj, të miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. (QSHA)</p>
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit MP në MNX, që i jep mundësi atij të vazhdojë studime të tjera</p>

Greata 


Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	Rregullorja e UniBA përcakton ruajtjen për një afat të pacaktuar të kopjes së dokumentacionit të plotë për çdo student. Ky dokumentacion aksesohet në rast nevojë informacioni edhe nga institucione si MASR. <i>Evidenca 5. Rregullore e UniBA</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.	Nga shqyrtimi i RVB dhe takimet fizike, konstatuam se institucioni mbledh dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit akademik sipas organigramës së UniBa në lidhje me strukturën analitike të FSHSTS, në rang njësie dhe personelin përkatës. Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional (DSHETP) mbledh, ruan dhe përditëson angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik të përfshirë në program dhe personat përgjegjës për organizimin e programit të studimit. <i>(Evidencë 44Formati i dosjes personale te stafit).</i>
Kriteri 2 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në	GVJ konstatoi se DSHETP në bashkëpunim me Zyrën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, harton dhe zbaton procedura specifike për përzgjedhjen e personelit në përputhje me nevojat e programit që fillojnë me shpalljen e

Guat



<p>përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>thirrjes online, përgatitjen e komisionit të vlerësimit, i cili merr vendimin në bazë të kritereve të përcaktuara në bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme të Rregullores së UniBa. <i>(Evidencë 5 Rregullore UniBA)</i></p> <p>Procedura e rekrutimit për personel të ri akademik bëhet mbi bazën e nevojave që paraqiten nga çdo njësi bazë (departament) e fakultetit, në fillim të vitit akademik. Dekani i fakultetit ia përcjell këto kërkesa Rektoratit, për të vijuar më tej me procedurat e konkurrimit. Shpallja për vende vakante bëhet publike, ku thirrja pasqyrohet dhe në faqen web të universitetit. <i>(Evidencë 44Formati i dosjes personale te stafit).</i></p>
<p>Kriteri 3 Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Rezultun se çdo ndryshim në lidhje me nevojat e njësisë, propozohet nga DSHETP, i dërgohet për miratim Zyrës së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, shoqëruar me arsyetimin përkatës. Më pas institucioni harton procedura e kritere specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p> <p>Procedura e rekrutimit për personel të ri akademik bëhet mbi bazën e nevojave që paraqiten nga çdo njësi bazë (departament) e fakultetit, në fillim të vitit akademik dhe çdo semestër, duke dërguar kërkesën përkatëse Zyrës së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, e cilafillon procedurat me shpalljen e thirrjes online, përgatitjen e komisionit të vlerësimit, i cili merr vendimin në bazë të kritereve të përcaktuara në bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme të Rregullores së UniBa.<i>(Evidencë 5)</i></p> <p><i>(Evidencë 11 Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performacës), (Evidencë 44Formati i dosjes personale te stafit).</i></p> <p><i>(Evidencë 5 Rregullore UniBA)</i></p>
<p>Kriteri 4 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Konstatuam se vlerësimi për përzgjedhjen e personelit realizohet nga Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, bazuar në propozimin e departamentit, e cila përditëson në mënyrë të vazhdueshme të dhëna që lidhen me aktivitetin kërkimor të stafit akademik, CV e tyre akademike, kontratat, formularët e parashikimit dhe realizimit të ngarkesës mësimore. Nga vizita në institucion konstatuam se Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik të DSHETP. Bazuar ne kuadrin ligjor ajo arkivon dosjet përkatëse për çdo anëtar të PAE dhe PAK, si dhe marrëveshjet kontraktuale të nënshkruara me stafin</p>

Guato 

	akademik në përfundim të gjithë procesit të rekrutimit. (Evidencë 11 Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performacës)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Nga shqyrtimi i RVB dhe takimi me Zyrën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, konstatoam që institucioni zbaton procedura ligjore për përzgjedhjen e personelit në përputhje me nevojat e programit të studimit. DSHETP në bashkëpunim me Zyrën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, harton procedurat për shpalljen e thirrjes online, përgatitjes së komisionit të vlerësimit, i cili merr vendimin në bazë të kriterëve të përcaktuara në bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme të Rregullores së institucionit. Rezultoni se institucioni është angazhuar për krijimin e mjedisëve të përshtatshme duke ndërtuar Kampusin e Ri. Siperfaqja për personelin akademik e ndihmës akademik është 320m ² (Evidencë 42) (Evidencë 5 Rregullore UniBA); (Evidencë 11 Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performacës; (Evidencë 42) Te dhenat te plota per infrastrukture);
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Konstatuam se Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik të DSHETP. Ajo arkivon dosjet përkatëse të personelit akademik, si dhe të marrëveshjeve të nënshkruara me stafin akademik në përfundim të gjithë procesit të rekrutimit. Stafi akademik është i angazhuar për kualifikim të vazhdueshëm profesional brenda dhe jashtë vendit. (Evidencë 43.1 Lista e konferencave, Work shop, Trajnimeve 2015 +); Evidencë 11 Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performacës

Auto



<p>të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Auditorët gjithashtuanë të pajisur me mjetet e nevojshme didaktike, për të zhvilluar veprimtaritë mësimdhënëse teorike dhe praktike.</p> <p><i>(Evidencë 42 Te dhenat te plota per infrastrukture);</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Konstatuam se disa nga mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, biblioteka janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies. FSHSTS ka kapacitet infrastrukturor dhe hapësira të plota për akomodimin e studentëve te programit Master Profesional Edukim me profil Mësimdhënia e të Nxënit, duke përmbushur kështu standardet e duhura 7.08 m² për student.</p> <p><i>(Evidencë 42 Te dhenat te plota per infrastrukture);</i> <i>(Evidencë 42.b Raport i ekspertit per infrastrukturen);</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Nga vizita e mjediseve konstatuam se auditorët mësimorë janë të pajisur me mjetet e nevojshme për realizimin e procesit mësimor (banga, karrike, pajisje audiovizive, tabela etj). Sallat e leksioneve në të cilat zhvillohen lëndët e programit të studimit janë të pajisura me videoprojektorë.</p> <p>Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion konstatuam se mjediset mësimore si zyra, salla leksionesh, laboratorë, sallë konferencash janë të pajisuara me mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të kurseve qe ofron ky program studimi për aftësimin teorik dhe detyrat praktike formues të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>Nga vizita në terren, konstatuam se laboratorit i informatikës është i pajisur me softuerët përkatës në mënyrë që të t'i shërbejë sa më mirë programit mësimor me një kapacitet afërsisht 30 vendesh. Ai është në parametra të mirë për realizimin e nevojave të programit të studimit në lidhje me përdorimin e teknologjisë në drejtim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Laboratori, rezulton se shërben për zhvillimin e detyrave të kursit të studentëve, por edhe për aktivitete të ndryshme nga vetë departamenti. Një punonjës i IT-së është në dispozicion të mirëmbajtjes së laboratorit dhe rrjetit kompjuterik të UniBa-së gjatë kohës së zhvillimit të orëve mësimore, si dhe ofron asistencë teknike për studentët dhe stafin akademik.</p>

Qus

<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Konstatohet se institucioni është angazhuar për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin profesional të personelit për metodat inovative të mësimdhënies si dhe të përdorimit të teknologjive të reja si platforma Google Classroom, Google Hangouts Meet, etj.</p> <p><i>(Evidencë 59b Manual i mesimdhënies online);</i> <i>(Evidenca 59 mesimdh online umb guide 2020)</i> <i>(Evidencë 43.1 Lista e konferencave, Work shop, Trajnimeve 2015 +);</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Institucioni dhe DSHETP dëshmojnë të kenë burimeve njerëzore të përshtatshme për përbushjen e objektivave të programit të studimit Master Profesional Edukim me profil Mësimdhënia e të Nxënës dhe mjedise të përshtatshme për krijimin mundësive të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. DSHETP, në çdo fillim viti akademik, planifikon paraprakisht ngarkesën mësimore për çdo anëtar të personelit akademik të departamentit si dhe ndjekjen e politikave për rekrutimin e personelit të nevojshëm për plotësimin e objektivave mësimore të këtij program studimi.</p> <p><i>(Evidencë 23 Te dhena tabelore per personelin akadm);</i> <i>(Evidenca 25Te dhenat tabekore me ngarkesen e plote);</i> <i>(Evidencë 42 Te dhenat te plota per infrastrukture);</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Në përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/ëve të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike</p>	<p>Nga vizita e mjediseve të institucionit konstatuam se lëndët e programit Master Profesional Edukim me profil Mësimdhënia e të Nxënës zhvillohen në Kampusin e ri 2 të Universitetit Barleti. Infrastruktura e universitetit përmban auditore me përmasa të mëdha dhe me kushte të mira fizike.</p> <p>Të gjitha auditoret janë të pajisura me kompjuter dhe video-projektorë si dhe ekrane, të cilët mundësojnë mësimdhënien me metoda të ndryshme si power-point, imazheri etj.</p>

Guato



<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Konfirmojmë që institucioni ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione arsimore parauniversitare, për realizimin e praktikave mësimore të studentëve të programit të studimit Master Profesional Edukim me profil Mësimdhënia e të Nxënit. Me mundësitë dhe infrastrukturën që ka, UniBa ka kapacitete të mjaftueshme për të organizuar veprimtari praktike apo veprimtari të posaçme vetë ose edhe në bashkëpunim me institucione të tjera.</p> <p><i>Evidenca 34 Marrëveshje bashkëpunimi me instituc;</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.4</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion konstatoam se biblioteka është e konceptuar në disa mjedise të ndërlidhura së bashku. Një mjedis ku janë vendosur librat universitar, rezultojnë të pakët në numër, me dy ulëse me pajisje teknologjike e lidhur me një open space 18 ulëse leximi ku studentët kanë mundësi të ulen dhe të shfrytëzojnë literaturën. Gjithashtu një mjedis tjetër i hapur, vendosur në godinën 2, është konceptuar si sallë qendrimi dhe leximi për libratartistic.</p> <p>Gjate vizitës konstatoam që Biblioteka nuk funksionon me kartelë regjistrimi, por vetëm me kërkesa online të studentëve të cilët paraqesin kërkesën e tyre për shfrytëzimin e librave. Studentët kanë të drejtë të regjistrohen dhe të përdorin literaturën e nevojshme në mjediset e bibliotekës, si dhe të tërheqin gjithashtu literaturë për shfrytëzim jashtë mjedisëve të bibliotekës. Nga biseda e zhvilluar me personin përgjegjës të bibliotekës së UNiBa, konfirmuam se nuk disponojnë instrumente matës për numrin e studentëve të regjistruar në bibliotekën fizike dhe në bibliotekën online.</p> <p><i>(Evidencë 42 Te dhenat te plota per infrastrukture);</i></p>


Guat



	<p><i>GVJ rekomandon hartimin e instrumenteve matës dhe mbajtjen e rekordeve për regjistrimin e studentëve në bibliotekën fizike dhe aksesimin e tyre në bibliotekën digjitale.</i></p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në vizitën në institucion, rezulton se numri i teksteve, lidhur me zhvillimin e programit të studimit Master Profesional Edukim me profil Mësimdhënia e të Nxënit në gjuhë shqipe është pasuruar duke plotësuar rekomandimin e lënë nga akreditimi i mëparshëm, duke shtuar 40 tituj në gjuhën shqipe. Librat në versionin pdf janë 144 tituj. E-Book janë 16 tituj. Revista shkencore janë 12 tituj. Krahas kësaj literature që është me prezencë fizike në bibliotekë funksionon dhe biblioteka online si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Econbiz management in education 45,659 articles; educational psychology 2,778 articles; ethics in education 4,213 articles; teaching planning 3,054 articles; teaching theories 1,635 articles. • Jstor (books and journals) management in education 444,949 articles; educational psychology 183,632 articles; ethics in education 173,564 articles; teaching planning 197,301 articles; teaching theories 176,060 articles. • Springer Link management in education 106,921 articles and 162 books; teaching 81,333 articles and 163 books; educational psychology 32,191 articles and 87 books; ethics in education 116,152 articles and 83 books; teaching planning 38,548 articles and 251 books; teaching theories 31,939 articles and 102 books. • Ebsco open dissertation management in education 1,922 articles; educational psychology 5,771 articles; ethics in education 289 articles; teaching planning 275 articles; teaching theories 637 articles. • DOAJ (Open Access journals: <i>Kategoria Articles</i>) management in education 51,699 indexed articles; educational psychology 16,750 indexed articles; ethics in

	education 8,792 indexed articles; teaching planning 4,118 indexed articles; teaching theories 1,948 indexed articles. <i>Evidenca 45 Lista e teksteve ne Biblioteke</i>								
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Nga vizita në institucion, konstatuam semenaxhimi i librave të bibliotekës realizohet nëpërmjet platformës online për të krijuar kushte për akses të shpejte, të barabartë e pa pagesë për studentët. (<i>Evidencë 42 Te dhenat te plota per infrastrukture</i>);								
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Rezulton se institucioni ka krijuar mundësi për aksesim e studentëve në platformën on-linetë bibliotekës ku mund të paraqesin kërkesat e tyre për shfrytëzimin e librave fizik dhe digjital. Institucioni i ofron studentëve, nëpërmjet linqeve që gjenden në platformë, akses në bibliotekat online ndërkombëtare si: Econbiz, JSTOR, Research4life me të cilën unistitucioni ka edhe një marrëveshje bashkëpunimi (<i>Evidencë 42 Te dhenat te plota per infrastrukture</i>);								
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Konfirmojmë që pavarësisht përpjekjeve të institucionit për pasurimin e bibliotekës, fondi i librave në shërbim të këtij program studimi vënë në dispozicion të studentëve mbetet ende i vogël. Institucioni nuk ka paraqitur një evidencë që të dokumentojë praktikën që ndjek për blerje tekstesh për shtimin e zërave të bibliotekës në rang departamenti apo/dhe evidencë për propozimet që departamenti bën gjatë fillimit të vitit akademik. <i>Evidenca 45 Lista e teksteve ne Biblioteke</i> <i>GVJ rekomandon që institucioni të harotjë çdo vit një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës dhe përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</i>								
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Edhe pse gjatë vizitës konstatuam që biblioteka nuk funksionon me kartelë regjistrimi, por vetëm me kërkesa online të studentëve të cilët paraqesin kërkesën e tyre për shfrytëzimin e librave biblioteka ka vënë në dispozicion të studentëve orare shërbimi, për të qënë në dispozicion të nevojave të studentëve. Biblioteka punon gjatë orarit 08:00-16:00 nga e hëna në të premte.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Qeset



Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Konstatohet se UniBa përdor sistemin Portali Studentor. Gjithashtu konstatohet që sekretaria mësimore disponon statistika vjetore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas programeve të studimit dhe cikleve të studimit; • të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve të secilit viti akademik; • të dhëna për transferimet dhe reregjistrimet; • të dhëna për ecurinë akademike të studentit; • numrin e ECTS të grumbulluara për secilin vit akademik; • të dhënat e studentëve që diplomohen;
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Bazuar në Raportin Vjetor të DSHETP, rezultojnë se institucioni disponon informacion të plotë për aktivitetin mësimor dhe atë kërkimor-shkencor të personelit akademik.</p> <p>Ndërsa në listën e marrëveshjeve në funksion të programit të studimit shprehet qartë aktiviteti që institucioni ka, në rang njësie kryesore dhe njësie bazë me partnerët të cilët janë të angazhuar në realizimin e këtij programi studimi.</p> <p>Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, disponon dhe arkivon dokumentacionin për personelin akademik, personelin ndihmës akademik, personelin administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Ndërsa DSHETP monitoron dhe nxit aktivitetin mësimor dhe kërkimor-shkencor.</p> <p><i>Evidenca 24 Te dhëna tabelore per personelin akade per prog e stud.</i></p> <p><i>Evidenca 25 Te dhenat tabelore me ngarkesen e plote.</i></p> <p><i>Evidenca 37 Raportet vjetore te publikuara per monit</i></p> <p><i>Evidenca 34 Marrëveshje bashkëpunimi me instituc</i></p> <p><i>Evidenca 43 Te dhëna per aktivitet kerkimi shkenc.</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e</p>	<p>Nga takimi me sekretarinë mësimore konstatohet se ajo ruan të gjithë dokumentacionin e domosdoshëm për çdo student në</p>

Buaf

dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	versionin fizik dhe i hedh këto të dhëna elektronikisht në formatin e Regjistrimit Themeltar të Studentëve dhe Regjistrimit të Diplomimit. (Evidenca 9 Rregulore për Sekretarinë Mesimore)			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Nëpërmjet sistemit Portali Studentor (Evidenca 48b1) rezulton se institucioni menaxhon sistemin e regjistrimeve, kurrikulën, grafikun e provimeve online, hedhjen dhe ruajtjen e vlerësimit, fazën e paradiplomimit dhe diplomimit. Studentëve u jepen të dhënat e aksesit të llogarive individuale për regjistrimin përfundimtar në mënyrë që ata të aksesojnë atë në çdo kohë, nga çdo pajisje që ka lidhje interneti. Sekretaria mesimore mban në sistem edhe të dhëna personale të studentëve si numra telefoni, adresa emaili dhe ruan kontakte të vazhdueshëm me studentët në raste njoftimesh. Të dhënat personale të tyre si datëlindja, qyteti i lindjes, adresa kontakti, etj. (Evidenca 9 Rregulore për Sekretarinë Mesimore)			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Nëpërmjet Planit Strategjik të Institucionit UniBa dhe të dhënave për konferencat dhe trajnimet, rezulton se institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ të monitorojë hedhjen në kohë të dokumentacionit të kërkuar, përmbushjen e zhvillimit të leksioneve online nëpërmjet platformës Google Classroom dhe Google Hangouts Meet. (Evidencë 59 & 59.b) <i>Evidenca 3 Strategjia e Zhvillimi Institucional</i> <i>Evidenca 43.1 Lista e konferencave, Work shop, Trajnimeve 2015</i> <i>Evidenca 59 b. Manual i mesimdhënieve online</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Konfirmojmë që në faqen zyrtare të internetit të UniBa janë publikuar të dhëna në lidhje me strukturën organizative, stafin akademik, veprimtaritë, bazën ligjore, kurrikulat dhe kalendari akademik, kriteret e përzgjedhjes së studentëve si dhe njoftimet të ndryshme që lidhen me veprimtarinë akademike të UniBa, në dy gjuhë: shqip dhe anglisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi IV.6

Guoto 

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në RVB institucioni harton çdo fillim viti buxhetin financiar i cili miratohet nga Senati akademik dhe Administratori, ku deklarohen kostot e shpenzuara, të ardhurat dhe përcaktimi i tarifës së shkollimit.</p> <p>UniBa harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare. Në raport pasqyrohen të dhëna financiare në lidhje me koston për secilin program studimi, duke bërë kështu edhe një vlerësim të ecurisë dhe vazhdimësisë së programeve, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e vendosura. Në to përfshihet kosto për çdo program studimi, kostot operationale dhe të mirëmbajtjes, etj.</p> <p><i>(Evidenca 50, 50a. Te dhena nga plani i financimit te programit)</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore shërbim të realizimit të programit shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekën on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Konfirmojmë që institucioni ka paraqitur një plan financiar për këtë program studimi. Në Planin e Analizës së Tregut të Punës, për këtë program studimi trajtohet teorikisht, tangent, raporti kosto/përfitime, por pa përcaktuar vlerat e këtij raporti. Ndersa plani i financimit të dërguar për këtë program studimi specifikon shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor</p> <p><i><u>GVJ rekomandon</u> që Institucioni të hartojë planin financiar të programit të studimit Master Profesional Edukim me profil Mësimdhënia dhe të Nxënit, ku të përmbajë gjithashtu financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit.</i></p> <p><i>Evidenca 16 Studimi per tregun e punes para hapjes se programit</i> <i>Evidenca 17 Studimi p-er tregun e punes pas daljes se studenteve</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB rezulton se procedura për hartimin dhe miratimin e projekt buxhetit afatmesëm fillojnë në gjysmën e dytë të vitit akademik, pasi janë marrë parasysh nevojat e njësisë kryesore të institucionit. <i>(Evidencë RVB).</i></p>

Qweto



të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.									
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Konstatohet se në mbyllje të çdo viti kalendarik, institucioni dokumenton raportin financiar për 1 vit kalendarik dhe konstatohet se në bilancin e vënë në dispozicion, <i>Institucioni nuk ka hartuar një plan veprimi për ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</i> <i>Evidenca 49 Te dhena nga raporti financiar vjetor.</i> <i>Evidenca 50, 50a. Te dhena nga plani i financimit të programit</i>								
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	Konstatohet se bilanci i vënë në dispozicion nga institucioni dëshmon se UniBa garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen, për këtë program. <i>Evidenca 49 Te dhena nga raporti financiar vjetor.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit

Guato

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Në përputhje me legjislacionin në fuqi, Uni Ba ka hartuar statutin dhe rregulloren e universitetit, të cilat përcaktojnë dhe specifikojnë politikat dhe procedurat që ndjek institucioni për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit. GVJ përmes dokumentacionit të dorëzuar konfirmon që këto akte janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Diplomimi i studentëve bëhet në përputhje me rregulloren e programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 2 Statusi i Universitetit Barleti</i></p> <p><i>Evidenca 5 Rregullore UniBA</i></p> <p><i>Evidenca 7 Rregullore Programit MP, MNX</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Konstatojmë që institucioni ka ngritur komisionet përkatëse, pranë departamentit, ku nëpërmjet Rregullores së Regjistrimeve dhe Transferimeve ka hartuar politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje duke garantuar barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë në këtë program studimi. Konfirmojmë që procedurat dhe kriteret e pranimit janë konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në përputhje me politikat e hartuara nga institucioni.</p> <p><i>Evidenca 7 Rregullore Programit MP, MNX</i></p> <p><i>Evidenca 9 Rregullore per Sekretarine Mesimore</i></p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Rezultton se përpapa fillimit të çdo viti akademik institucioni me propozim nga DSHETP dhe miratim nga Senati Akademik, harton kriteret dhe procedurat për hyrjen në programin e studimit “Master Profesional në Edukim me profil Mësimdhënia dhe të Nxënët”, duke garantuar shance të barabarta për të gjithë kandidatët nëpërmjet shpërndarjes së kuotave për kategori të veçanta si për kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare si dhe personat me aftësi të veçanta.</p> <p><i>Evidenca 7 Rregullore Programit MP, MNXkap XII;</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Konstatojmë se institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret dhe kuotat e pranimit në programet e studimit që ofron UniBa, sipas legjislacionit në fuqi dhe i publikon ato online.</p> <p>UniBa, ka hartuar politika të qarta për promovimin dhe informimin e kandidatëve për student për programet dhe mundësitë për studim që ofron.</p> <p><i>Evidenca 7 Rregullore Programit MP, MNX</i></p>

Gueta 

<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>Rezulton se institucioni, përpara fillimit të çdo viti akademik publikon online kriteret e pranimit për secilin program studimi. (https://fshsts.umb.edu.al/departamenti-shkencave-te-edukimit-dhe-trajnimet-profesional.html). Plani i programit të studimit i bëhet e ditur studentit që në momentin e regjistrimit. Në faqen e internetit të UniBa, gjendet në çdo kohë “Broshura UniBa”.https://umb.edu.al/upload/studiesbroshures/BROSHURA_UNIBA_22-PRILL-2021.pdf</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.2</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Konstatohet që programet e studimit, të detajuara me lëndët dhe modulet që përmban, i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit. Ato janë të publikuara në faqen e internetit të UniBa, sipas fakulteteve përkatëse (https://fshsts.umb.edu.al).</p> <p>Në fillim të vitit akademik studentët familjarizohen me materiale udhëzuese si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Manuali i rekrutimeve, aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UniBa dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore, vlerësimin dhe diplomimin. (Evidencë 65) • Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional Edukim me profil Mësimdhënia e të Nxënës, përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit nga njëri vit në tjetrin. (Evidencë 7) • Syllabuset e moduleve përkatëse për çdo semester nga lektori i lëndës në të cilat janë të specifikuar kriteret

Guat

	<p>dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitet e diplomimit tyre në programin e studimit. (<i>Evidencë 19</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kurrikulën e Programit të Studimit Master Profesional Edukim me profil Mësimdhënia e të Nxënit (<i>Evidencë 14</i>) • Kalendarin akademik në të cilën përcaktohen datat e provimeve, riprovimeve dhe sezonet e mbartura, diplomimet etj. <p>(https://umb.edu.al/kalendar-akademik.html)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Nëpërmjet Rregullores së Programit të Studimit Master Profesional Edukim me profil Mësimdhënia e të Nxënit, përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit të vitit akademik dhe manuali i rekrutimeve, aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UniBa dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore, vlerësimin dhe diplomimin.</p> <p><i>Evidenca 65. Manual - Rekrutim-Aplikim-Regjistrim-Transferim</i> <i>Evidenca 7 Rregullore Programit MP,MNX</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Konstatohet se bazuar në Rregulloren e UniBa, në Manualin e Studentit dhe syllabuset e moduleve përkatëse për çdo semestër nga lektori i lëndës janë të specifikuar kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit të tyre në programin e studimit Master Profesional Edukim me profil Mësimdhënia e të Nxënit.</p> <p><i>Evidenca 5 Rregullore UniBA</i> <i>Evidenca 65. Manual - Rekrutim-Aplikim-Regjistrim-Transferim</i> <i>Evidenca 19 Syllabuset e lendeve</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në Rregulloren e Programit të Studimit “Master Profesional Edukim me profil Mësimdhënia e të Nxënit, janë të përcaktuara qartë kriteret dhe procedurat e diplomimit në këtë program studimi.</p> <p><i>Evidenca 7 Rregullore Programit MP,MNX</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe vizitat në institucion, u informuam se DSHETP, në fillim të vitit të parë të</p>

Guato

periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	studimeve në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Alumni, organizon javën orientuese me studentët e rinj gjatë të cilit prezantohet stafi akademik i përfshirë në programin e studimit, jepet informacion rreth plan programit dhe orientohen në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës. <i>Evidenca 51 Politika e marketingut te prog.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Joq	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Konstatojmë që nëpërmjet “Manualit të Studentëve”, studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e institucionit, organizimin, njësitë dhe organet përgjegjëse për marrjen e informacionit për mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt tregut të punës. Komunikim i brendshëm mes studentëve, stafit akademik dhe sekretarisë mësimore realizohet nëpërmjet Portali Studentor, si dhe Google Classroom. Aty studenti mund të aksesojë në çdo kohë informacionin e nevojshëm në lidhje me kurrikulën e programit të studimit, lëndët/modulet dhe ngarkesat përkatëse, syllabuset dhe format e vlerësimit për secilën, informacion në lidhje me frekuentimin, grafikun e provimeve, auditorët, etj. <i>Evidenca 65. Manual - Rekrutim-Aplikim-Regjistrim-Transferim</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Rezulton se në fillim të vitit akademik studentët pajisen me materiale udhëzuese si Manuali i Studentit dhe Rregullorja e Programit të Studimit “Master Profesional Edukim me profil Mësimdhënia e të Nxënit, përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit nga njëri vit në tjetrin. Sezonet e provimeve, riprovimeve dhe sezonet e mbartura përcaktohen gjithashtu edhe në Strukturën e Vitit Akademik dhe si të tilla ruhen në sistem dhe u bëhen të ditura

Q. Stafa

	<p>studentëve që në fillim të vitit akademik, të cilat publikohen në faqen zyrtare të UniBa.</p> <p><i>Evidenca 65. Manual - Rekrutim-Aplikim-Regjistrim-Transferim</i></p> <p><i>Evidenca 7 Rregullore Programit MP,MNX</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Konstatojmë se Zyra Karrierës dhe Alumnit informon studentët mbi mundësitë e punësimit dhe mbështetjen institucionale të tregut të punës. Zyra e Karrierës dhe Alumnit orienton studentët për zgjedhjen e karrirës së tyre, rritjen e kontakteve, vetëpunësimin dhe mundësitë për tregun e punës si dhe mban rekorde për Alumnin.</p> <p><i>Evidenca 29 Te dhenat tabelore permbledh per punesim e stud</i></p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Çdo fillim të vitit të parë të studimeve, DSHETP, në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Alumni, organizojnë javën orientuese me studentët e rinj gjatë të cilit prezantohet stafi akademik i përfshirë në programin e studimit, jepet informacion rreth plan programit dhe orientohen në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës. Në faqen e internetit të UniBa, gjithashtu gjendet i publikuar informacioni plotë për strukturat e UniBa dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretaritë mësimore, bibliotekën, laboratorët etj.</p> <p><i>Evidenca 51 Politika e marketingut te prog</i></p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance</p>	<p>Konstatojmë se informimi i studentëve, realizohet nëpërmjet Portali Studentor, si dhe Google Classroom, sikurse pohuan edhe vetë studentët gjatë takimit fizik, arrijnë të ndërveprojnë gjatë realizimit të procesit mësimor. Ndërsa informacioni mbi kurrikulat e studimit, aktivitetet dhe kalendarin mësimor publikohen online dhe janë lehtësisht të arritshëm nga studentët në distancë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.4


Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Gueto

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Raportit të Vetëvlerësimit të Programit dhe Plani strategjik për zhvillimin e programit, kostatojmë se institucioni paraqet raporte vjetore për veprimtarinë e kryer.</p> <p>Konstatojmë, gjithashtu, që institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për secilin program studimi që UniBa ofron, specifikisht për Master Profesional Edukim me profil Mësimdhënia e të Nxënit rezultojnë të regjistruar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • për vitin akademik 2018-2019 në total 13 studentë; • për vitin akademik 2019-2020 në total 13 studentë; • për vitin akademik 2020-2021 në total 10 studentë; <p><i>Evidenca 4 Plani Strategjik per Prog MP MNX</i> <i>Evidenca 28.1 Tabela Nr 21.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe Rregullorja e UniBa, rezulton se Sekretaria Mësimore është zyra e cila është përgjegjëse për menaxhimin e procesit të regjistrimit të studentëve, për rregullimin, monitorimin dhe arkivimin e çdo regjistrimi, informacioni, dokumenti apo transkripti lidhur me studentët.</p> <p>Nga vizita në institucion me sekretarinë mësimore konstatojmë se ajo disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notës mesatë hyrëse dhe dalëse, gjithashtu administron dhe ruan të dhënat mësimore të studentëve dhe të procesit mësimor në regjistrin themelar të studentëve, sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>Evidenca 5.Rregullore e Universitetit Barleti;</i> <i>Evidenca 9.Rregullore e Sekretarise Mesimore;</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Nga vizita në institucion me përfaqësues të Zyrës e Karrierës dhe Alumnit (ZKA) konstatojmë se ajo mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre. Rezulton se ZKA, bazuar edhe në Rregulloren e ZKA, ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë për çështje akademike, mobilitet studentor si dhe informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo/edhe aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit.</p> <p><i>(Evidenca 29. Të dhëna për diplomimin);</i> <i>(Evidencë33. Tabelë për trajnime profesionale);</i></p>

<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Nga takimi virtual rezultoi se sekretaria mësimore e FSHSTS disponon statistika vjetore për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas programeve të studimit dhe cikleve të studimit. Gjithashtu ajo ruan të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve të secilit vit akademik, transferimet dhe çregjistrimet, ecurinë akademike të studentit, numrin e ECTS të grumbulluara për secilin vit akademik, si dhe të dhënat e studentëve që diplomohen, përfshi edhe temën e diplomimit. Sekretaria ruan dokumentacionin e domosdoshëm për çdo student në versionin fizik dhe i hedh këto të dhëna elektronikisht në platformën digjitale on.alabnianuniversity.edu.al</p> <p><i>Evidenca 9. Rregullore e Sekretarise Mesimore;</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>Konstatohet se institucioni harton në mënyrë periodike raporte vjetore në rang njësie bazë. Sekretaria Mësimore gjithashtu disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notën mesatare hyrëse dhe dalje, por:</p> <p><i>Institucioni nuk ka paraqitur një raport analitik periodik mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre.</i></p> <p><i>(Evidencë 38. Analiza mbi arritjen e objektivave);</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi V.5</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve</p>	<p>Konstatohet që studentët e UniBa janë të përfshirë në vendimmarrje, këshillim dhe vlerësimin mbi procesin akademik në organet kolegjiale të institucionit. Ata kanë përfaqësues në Senatën Akademik, në Këshillin e Etikës si dhe në NjZHKC. <i>(Evidencë Plan i punës i NjZHKC);</i></p>

Guato 

ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Rezulton që institucioni është i angazhuar që të garantojë përfshirjen e studentëve në vendimmarrje nëpërmjet përfaqësuesve në Senatën Akademik, në grupin e ngritur nga NjZHKC për hartimin e GVB në kuadër të sigurimit të cilësisë. Gjithashtu një nga strukturat e ngritura në UniBa është edhe Këshilli i Studentëve. <i>(Evidencë 16. Studim tregu para hapjes së programit);</i> <i>(Evidencë Plan i punës i NjZHKC);</i>
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Rezulton se institucioni gjatë hartimit të programit të studimit Master Profesional Edukim me profil Mësimdhënia e të Nxënit <i>(Evidencë mungon)</i> , ka respektuar Ligjin Nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe VKM nr. 41/2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, duke iu përmbajtur ngarkesës mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, jo më shumë se 25 orë mësimore në javë. Sasia mesatare e punës së kryer gjatë Programit të Studimit Master Profesional Edukim me profil Mësimdhënia e të Nxënit, është 120 kredite ose 1500 orë mësimore punë të studentit për çdo vit akademik. Në Programin e Studimit për Master Profesional Edukim me profil Mësimdhënia dhe të Nxënit, studentët zhvillojnë 1019.4 orë në auditor dhe 1980.6 orë punë të pavarur. <i>(Evidencë shtesë 7. Rregullore e programit të studimit MPMP);</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Konstatohet se studentët janë të përfshirë në komisionet e ngritura nga NjZHKC, që kanë për detyrë të monitorojnë cilësinë e zbatimit të kurrikulës në cikle të ndryshme të studimit si dhe të mbështesin punën e njëjësive bazë për akreditimin, hartimin e programeve të reja të studimit etj, si dhe janë pjesë e GVB, për hartimin e RVB për Programin e Studimit Master Profesional Edukim me profil Mësimdhënia e të Nxënit. <i>(Evidencë 16. Studim tregu para hapjes së programit);</i> <i>(Evidencë 30. Të dhëna për anëtarët e NJBSC);</i>
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe	Nëpërmjet instrumenteve matës për vlerësimin e procesit mësimor, nga stafi akademik dhe pyetësori për studentët, studentëve u krijohet mundësia të japin mendim mbi barazinë


Eucate

ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana pedagogut përgjegjës. <i>(Evidencë 37. Raport i vlerësimit të brendshëm të studenteve);</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Konstatojmë se institucioni paraqet procedura të qarta për informimin e studentëve nëpërmjet Zyrës së Rekrutimit, Pranimit dhe Regjistrimit, Zyra e Dekanit të Studentëve, Zyra e Alumni dhe Karrierës si dhe Koordinatorit të Departamentit. Gjithashtu jashtë çdo departamenti ekziston këndi i informimit dhe njoftimeve që departamenti përkatës afishon. Zyra e Karrierës dhe Alumnit angazhohet në mbështetje të studentëve përgjatë gjithë ciklit të studimeve master. Zyra e Dekanit të Studentëve u vë në dispozicion atyre, materiale dhe broshura informuese dhe orientuese si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për programin e studimit që do ndjekin. Në ndihmë të këtij procesi, studentëve u vjen edhe informacioni që përmban Manuali i Studentit. <i>(Evidencë 12. Rregullore e Funkcionimit të Zyrave në Shërbim të Studenteve pranë UNIBA);</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të	Konstatojmë që nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të UniBa dhe Sekretarisë Mësimore, studentët kanë mundësi të informohen për mënyrën e regjistrimit të tyre, kryerjen e pagesave, aksesin në sistem, prenotimin në lëndët që duhet të japin provim etj. Gjithashtu, informacione më të detajuara për profilin e tyre personal, realizohet nëpërmjet Portali Studentor.

Gueto 

bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. .				
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Konstatohet se nëpërmjet Zyrës së Rekrutimit, Pranimit dhe Regjistrimit, Zyra e Dekanit të Studentëve, Zyra e Alumni dhe Karrierës, kandidatët për student, studentët dhe alumni marrin informacion dhe mbështetje për planifikimin e karrierës se tyre nëpërmjet trajnimeve, forumeve, projekteve, seminareve, takimeve informuese, tryezave të rrumbullakëta, takimeve të studentëve që institucioni organizon.</p> <p>Nëpërmjet “Manualit të Studentëve”, studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e institucionit, organizimin, njësitë dhe organet përgjegjëse për marrjen e informacionit për mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt tregut të punës. Gjithashtu ZAK ofron informacion për bursa, konferenca studimore, informacion në lidhje me mobilitetet dhe progamet e shkëmbimeve jashtë vendit. Praktikën profesionale zhvillohen në institucione shtetërore ose private, sipas profilit të përgatitjes së studentit.</p> <p><i>(Evidence 12. Rregullore e Funkcionimit të Zyrave në Shërbim të Studenteve pranë UNIBA);</i></p> <p><i>(Evidence 34. Marrëveshje bashkëpunimi aktive);</i></p> <p><i>(Evidence 43. a. Lista e konferencave, Workshop, Trajnimeve 2015-2020);</i></p> <p><i>(Evidence 65a. Udhëzim nr. 54, dt. 9.1.2019 për rekrutimet 2019-2020);</i></p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Konstatohet që ZAK gjurmon studentët pas diplomimit duke krijuar ura bashkëpunimi ndërmjet tyre dhe studentëve aktual të institucionit. Për periudhën 2018-2021 nga 25 studentë të diplomuar, 22 janë të punësuar në përputhje me diplomën.</p> <p><i>(Evidence 29. Të dhëna për diplomimin);</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X


Arta

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Bazuar në Ligjin nr.80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, rezulton se institucioni ka hartuar politika dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>Sigurimi i brendshëm i cilësisë në UniBa bazohet në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe në Standardet Shtetërore për Sigurimin e Cilësisë. Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë ngritur me Vendim të Senatit Akademik të UniBa. UniBa, ka një organizim strukturor të brendshëm në lidhje me sigurimin e cilësisë, si dhe ka përcaktuar modalitetet dhe procedurën përmes të cilave realizohet sigurimi i cilësisë dhe ndjekja periodike e vlerësimit të veprimtarive të kryera akademike dhe shkencore, në përbushje të standardeve të kërkuara. Ky sistem, përbëhet nga Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Standardeve të Cilësisë dhe Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë. Gjithashtu, në nivel institucional funksionon Komisioni për Vlerësimin e Performancës.</p> <p><i>(Evidencë 8. Rregullore e NjZhKC);</i> <i>(Evidencë 2. Statuti IAL);</i> <i>(Evidencë 5. Rregullore e Universitetit Barleti);</i> <i>(Evidencë 11. Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerezore);</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe</p>	<p>Konstatojmë që institucioni ka ngritur Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Standardeve të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku janë të përfshirë jo vetëm stafi akademik, por edhe studentët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm.</p> <p><i>(Evidencë 2. Statuti IAL);</i></p>

Gueta




studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	<i>(Evidencë 3. Strategjia e zhvillimit institucional.);</i> <i>(Evidencë 5. Rregullore e Universitetit Barleti);</i>			
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Konstatohet që institucioni përdor disa instrumente matëse për sigurimin e cilësisë siç janë pyetësor për studentët për matjen e cilësisë së procesit mësimor. Gjithashtu rezultojnë se Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë së UniBa, realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit institucional, raporteve analitike të vlerësimit të brendshëm që institucioni harton si dhe vetvlerësimit të programit të studimit. <i>(Evidencë 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit);</i> <i>(Evidencë 37. Raport i vlerësimit të brendshëm të studenteve.);</i> <i>(Evidencë 40. Formular vlerësimi i studentëve për lëndën);</i> <i>(Evidencë 40a. Guida per fokus grupin);</i>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	Rezultojnë se institucioni ka hartuar politika dhe procedura të qarta dhe periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron. Disa nga këto procedura periodike janë: <ul style="list-style-type: none"> - Pyetësor i stafit akademik për matjen e cilësisë të procesit mësimor, <i>(Evidencë 41);</i> - Pyetësor për studentët për matjen e cilësisë të procesit mësimor, <i>(Evidencë 40);</i> - Raporteve analitike të vlerësimit të brendshëm që institucioni harton' <i>(Evidencë 37);</i> - Plani strategjik i departamentit, <i>(Evidencë 4);</i> - Analiza e departamentit <i>(Evidencë 38);</i> - Analiza vjetore e punës kërkimore shkencore nga ana e institucionit, në rang departamenti <i>(Evidencë 43);</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënësve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Queto

<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB konstatojmë se vlerësimet e realizuara për elementë të caktuar të programeve të studimit në mënyrë periodike, çdo vit akademik, pasqyrohen në raportin vjetor të njësisë bazë, dhe në Planin strategjik të programit të studimit “Master Profesional Edukim me profil Mësimdhënia e të Nxënit.</p> <p><i>(Evidencë 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit);</i> <i>(Evidencë 35. Raport mbledhje dep. 13.9.2021);</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Rezulton se institucioni përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve nëpërmjet hartimit periodik të raportit të vlerësimit të brendshëm, i cili pëfshin analizën e objektivave të programeve të studimit që UniBa ofron, metodat e mësimdhënies, organizimin dhe administrimin e tyre si dhe format e vlerësimit.</p> <p><i>(Evidencë 13. Rregullore e NjZhKC-së.);</i> <i>(Evidencë 38. Analiza mbi arritjen e objektivave);</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm dhe Plani Strategjik i Departamentit, rezulton se institucioni përdor instrumente matës dhe metodologji vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p> <p><i>(Evidencë 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit);</i> <i>(Evidencë C);</i></p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Nëpërmjet instrumenteve matës për vlerësimin e pyetësoreve për matjen e cilësisë së procesit mësimor, rezulton se studentëve u krijohet mundësia të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana e pedagogut përgjegjës. Pas analizës e të dhënave përkatëse të dërguar nga institucioni rezulton se të dhënat e rezultateve u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p> <p><i>(Evidencë 37. Raport i vlerësimit të brendshëm të studentëve.);</i></p>
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit Strategjik të Departamentit, rezulton se institucioni ka përfshirë analizën SWOT, gjatë së cilës trajtohen rezultatet e vlerësimit, rezultatet e pritshme, mangësive dhe pritshmëritë për përmirësimin në vijim të cilësisë.</p> <p><i>(Evidencë 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit);</i></p>

Gueta 

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB rezulton se çdo vit akademik, në mënyrë periodike, hartohet Plani Strategjik i njësisë bazë, në të cilin pasqyrohen porpozimet për ndryshimet e plan programeve dhe elementëve të tjerë të programeve të studimit që DSHETP ofron dhe ia përcjell për miratim Senatit Akademik. Të gjitha këto ndryshime pasqyrohen në Strategjia e Zhvillimit Institucional. Konstatohet, gjithashtu se DSHETP kryen në mënyrë periodike Raportin e Vetvlerësimit të Programit të Studimit Master Profesional Edukim me profil Mësimdhënia e të Nxënës.</p> <p><i>(Evidencë 3. Strategjia e zhvillimit institucional);</i> <i>(Evidencë 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit);</i> <i>(Evidencë 38. Analiza mbi arritjen e objektivave);</i></p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Analiza e punës kërkimore shkencore në rang departamenti <i>(Evidencë 43.1);</i> - Strategji e Sigurimit të Cilësisë, <i>(Evidencë 37);</i> - Plani strategjik i UniBa, <i>(Evidencë 3);</i> - Plani Strategjik i programit të studimit, <i>(Evidencë 4);</i>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve</p>	<p>Rezulton se institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nga studentët <i>(Evidencë 40);</i> • Fokus grupet për vlerësimin e mësimdhënies <i>(40.a);</i> • Raportin e Vetvlerësimit të Programit të Studimit Master Profesional Edukim me profil Mësimdhënia e të Nxënës. <i>(Evidencë 38);</i>

Evato



<p>apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>									
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Institucioni realizon në mënyrë periodike dy pyetësore me studentët dhe fokus grupe:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Për vlerësimin stafit akademik nga studentët (<i>Evidencë40</i>). 2) Për vlerësimin e procesit të mësimdhënies dhe të nxëniet nga studentët (<i>Evidencë40</i>). 								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="593 1288 764 1375">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="764 1288 951 1375">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="951 1288 1131 1375">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1131 1288 1313 1375">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="593 1375 764 1431"></td> <td data-bbox="764 1375 951 1431"></td> <td data-bbox="951 1375 1131 1431" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="1131 1375 1313 1431"></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

<p>Standardi VI.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të</p>	<p>Rezulton që nëpërmjet analizës SWOT të Planit Strategjik të departamentit si dhe Raportin e Vetvlerësimit të Programit të Studimit Master Profesional Edukim me profil</p>

brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Mësimdhënia e të Nxënit, institucioni siguron përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. <i>(Evidencë 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit);</i>			
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Rezulton se institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët të cilët janë të angazhuar në GVB për Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të Programit të Studimit Master Profesional Edukim me profil Mësimdhënia e të Nxënit, duke garantuar kështu ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. <i>(Evidencë C);</i>			
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	Rezulton se anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit janë të përfshirë në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit në rang departamenti dhe fakulteti, siç pasqyrohet edhe në grupet e sigurimit të cilësisë në nivel njësie bazë si dhe në Rregulloren e Zyrës së Monitorimit. <i>(Evidencë 13. Rregullore e NjZhKC-së);</i>			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Bazuar në Rregulloren e Mbarëvajtjes së Kurrikulave dhe Procesit Mësimor në UniBa, rezulton se institucioni rregullon integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit akademik, ndihmësakademik dhe studentëve. <i>(Evidencë 8. Rregullore e NjZhKC);</i>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	Rezulton se, marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka me institucionet arsimore dhe jo vetem për realizimin e praktikave profesionale luajnë rol aktiv në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. <i>(Evidencë 34. Marrëveshje bashkëpunimi aktive.);</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Ques



				X
--	--	--	--	---

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Rezulton se institucioni ka hartuar politika të qarta për publikimin e veprimtarive në kuadër të sistemit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, të cilat janë transparente dhe bërë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare të UniBa.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Konfirmojmë që institucioni ka hartuar Rregulloren e UNIBa, Rregulloren në rang njësie kryesore, si dhe Planin Strategjik të Programit të Studimit Master Profesional Edukim me profil Mësimdhënia e të Nxënit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. <i>(Evidencë 5. Rregullore e Universitetit Barleti);</i> <i>(Evidencë 6a. Rregullore e fakultetit.);</i> <i>(Evidencë 7. Rregullore e programit të studimit MPMP);</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Konstatohet se në Planin Strategjik të Programit të Studimit Master Profesional Edukim me profil Mësimdhënia dhe të Nxënit është hartuar analiza SWOT e shoqëruar me një plan masash që synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara nga ky program. <i>(Evidencë 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit);</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Konstatohet se institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë, mbështetur në Rregulloren e NJZHKC, miratur nga Senati Akademik në vitin 2021. <i>(Evidencë 8. Rregullore e NjZHKC);</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët	Nga shqyrtimi i RVB dhe diskutimet e realizuara nga takimi me NJZHKC, rezultoi se institucioni organizon takime periodike me stafin akademik, ndihmës dhe studentët për t'i

Q. Stafa

[Signature]

për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	informuar për arritjet dhe rekomandimet që duhet të plotësojë institucioni për rritjen e cilësisë së institucionit në tërësi dhe programeve të studimit, në veçanti.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Edukim” me profil “Mësimdhënia dhe të nxënit”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Kurrikul me fokus të përqendruar në metodologjitë e mësimdhënies dhe nxënies;
2. Bashkëpunime për praktikat profesionale me shkolla të cilësisë së lartë;
3. Program që individualizohet në aspektin e nivelit të shkollimit (parashkollor, arsimit fillor, gjuhët, artet, shkencat sociale, matematikë, shkencat e natyrës, TIK, arsimit profesional);
4. Njëpërmjet ndërtimit të Kampusit të Ri institucioni është angazhuar për krijimin e mjediseve të përshtashme për zhvillimin e këtij program studimi;
5. Institucioni i ka krijuar mundësi aksesimi studentëve në platformën on-linetë bibliotekës ku mund të paraqesin kërkesat e tyre për shfrytëzimin e librave fizik dhe digjital, në bibliotekat online ndërkombëtare si: Econbiz, JSTOR, Research4life;
6. Institucioni është angazhuar për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin profesional të personelit për metodat inovative të mësimdhënies si dhe të përdorimit të teknologjive të reja;
7. Studentët e UniBa janë të përfshirë në vendimmarrje duke u përfaqësuar në organet kolegjiale të institucionit si Senatit Akademik, Këshilli i Etikës si dhe në NjZHKC;

b. Pika të dobta:

1. Institucioni nuk specifikon qartë praktikën që ndjek për blerje tekstesh për shtimin e zërave të bibliotekës për propozimet që departamenti bën gjatë fillimit të vitit akademik;
2. Institucioni nuk disponon instrumente matëse për numrin e studentëve të regjistruar në bibliotekën fizike dhe në bibliotekën online;

Guaf

3. Plani i financimit të këtij program studimi nuk përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit;

Rekomandime

1. Rekomandohet angazhim më i madh i pedagogëve në njohjen e mësuesve të shkollave të ndryshme me vlerat e këtij programi studimi nëpërmjet trajnimeve, konferencave, etj;
2. Rekomandohet angazhim i pedagogëve në publikimin e botimeve në ndihmë të studentëve të këtij kursi;
3. Rekomandohet që institucioni të hartojë çdo vit një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës dhe përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit;
4. Rekomandohet hartimi i instrumenteve matës për regjistrimin e studentëve në bibliotekën fizike dhe aksesimin e tyre në bibliotekën digjitale;
5. Rekomandohet që institucioni të hartojë planin financiar të programit të studimit Master Profesional Edukim me profil Mësimdhënia dhe të Nxënit, ku të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit;

Conclusions of the Evaluation of the study program of Professional Master in in "Education" with a profile in "Teaching and learning"

a. Strengths and affirmations:

1. Curriculum focused on teaching and learning methodologies;
2. Collaborations for professional practices with high quality schools;
3. Program that is individualized in terms of level of education (preschool, primary education, languages, arts, social sciences, mathematics, natural sciences, ICT, vocational education);
4. The institution is committed to creating suitable environments for the development of this study program, through the construction of the New Campus;
5. The institution has created opportunities for students to access the online platform of the library where they can submit their requests for the use of physical and digital books, in international online libraries such as: Econbiz, JSTOR, Research4life;
6. The institution is committed to the continuous qualification and professional development of staff for innovative teaching methods and the use of new technologies;
7. UniBa students are involved in decision-making by being represented in the collegial bodies of the institution such as the Academic Senate, the Ethics Council and the NjZHKC;

b. Weak points:

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

78

1. The institution does not clearly specify the practice it follows for purchasing textbooks to increase the library items for the proposals that the department makes during the beginning of the academic year;
2. The institution does not have measuring instruments for the number of students enrolled in the physical library and in the online library;
3. The financing plan of this study program does not contain the financing of human resources in the service of the realization of the program, the expenses for the library and the enrichment of the literature and the access to the on-line libraries, the financial obligations, the received local or foreign grants and the contracts. related services to realize the study program;

Recommendations

1. It is recommended greater involvement of lecturers in acquainting teachers at different schools with the values of this study program through trainings, conferences, etc;
2. It is recommended that lecturers be involved in publishing publications to help students in this course;
3. It is recommended that the institution draw up a detailed plan each year to increase the number of library items and update the existing fund in support of the program;
4. It is recommended to design measuring instruments for enrolling students in the physical library and accessing them in the digital library;
5. It is recommended that the institution drafts the financial plan of the Professional Master Study Program in "Education" with a profile in "Teaching and learning", which contains the funding of human resources in service of the implementation of the program, operating costs for the maintenance of facilities and teaching process support technologies, library expenditures and literature enrichment and access to on-line libraries, financial obligations, domestic or foreign grants received and service contracts concluded in order to carry out the study program;



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Gueta 